



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

*Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditit të Brendshëm.*

Nr.228/6 Prot.

Tiranë, më 23/07/ 2016

### V E N D I M

**Nr.98, Datë 23/07/ 2016**

#### PËR

### **EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË MINISTRINË E MIRËQËNIES SOCIALE DHE RINISË, “MBI ZBATIMIN E PËRPUTHSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE”.**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditit të Brendshëm, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 10 dhe 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

### V E N D O S A:

- I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”, të ushtruar në Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë”.
- II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

## A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e kryerjes së pagesave për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, u konstatua se nga institucioni i Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (në vazhdim MMSR) është likuiduar shuma prej 20,455,000 lekë, për subjektin “██████” sh.a, për shërbimet e telefonisë fikse ndaj shtresës me aftësi të kufizuara (paraplegjik e tetraplegjik dhe të verbër) periudhën qershor 2001- qershor 2008, si detyrim i pretenduar dhe që i referohet kërkesave të VKM nr.83, datë 26.02.2001 “Për tarifatat telefonike dhe për pagesat e energjisë elektrike nga personat me aftësi të kufizuara” i ndryshuar. Këto fonde janë përballuar nga Fondi i Kontigjencës, sipas vendimit të Komitetit të Detyrimeve të Prapambetura (KPD) në zbatim të strategjisë për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

a) Konstatuam se pagesa është bërë me urdhër shpenzimi nr.20 datë 28.01.2015, në referencë të Urdhrit nr.242 datë 17.12.2014 dhe Akt rakordimit nr.6483/1 datë 31.12.2014 dhe shkresës së Ministrisë së Financave nr.2/3 datë 20.01.2015.

Shkresa e Ministrisë së Financave nr.2/3 datë 20.01.2015 me subjekt “Akordimi i fondeve në zbatim të Vendimit nr.15 datë 09.01.2014 të Komitetit të Shlyerjes së Detyrimeve të Prapambetura”, i referohet “Vendimit të Komitetit të Detyrimeve të Prapambetura nr.15 datë 09.01.2014, si dhe shkresës së ardhur nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr.229/1 datë 14.01.2015, miratojmë detajimin e fondit sipas tabelave bashkëngjitur”. Shkresa mban firmën e Ministrit të Financës.

Lidhur me këtë praktikë kemi konstatuar që në referencë të shkresës së ██████ sh.a nr.10598/3, date 25.11.2014 “Dërgim informacioni”, ka dalë Urdhri nr.242 datë 17.12.2014 i Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për ngritjen e grupit të punës për rakordimin e detyrimeve ndaj ██████, mbi tarifatat e shërbimit telefonik fiks për personat me aftësi të kufizuara. Grupi i punës i koordinuar nga Drejtori i Financës ██████ ka në përbërje 15 anëtarë me përgjegjësi të njëjtë. Përgjegjësia e grupit të punës ishte rakordimi i detyrimeve të paraqitura nga shoqëria Albtelekom, për detyrimet sipas viteve Qershor 2001- Qershor 2008 dhe Maj 2012 - Korrik 2012.

Lidhur me Akt Rakordimin nr.6483/1 datë 31.12.2014 kemi konstatuar:

1. Dokumenti i Akt Rakordimit është firmosur vetëm nga pala e MMSR dhe nuk ka nënshkrime të palës së ██████. Dokumenti nuk është firmosur nga të gjithë pjesëtarët e grupit.

2. Në dokumentet e paraqitur, grupit të auditimit të KLSH-së, mungojnë dokumentet e detyrimeve të pretenduara, të tilla janë, lista e personave përfitues, statusi i tyre, faturat me numrin e impulseve dhe vlera, pjesa e paguar nga personi mbi shumën e rimbursueshme në se ka etj.

Akt Rakordimi cilëson pretendimin për shumën 89,154,753 lekë ndërkohë që grupi ka pranuar vetëm vlerën 21,015,098 lekë. Ndërkohë që për pjesën tjetër është cilësuar fakti se do të vazhdojë verifikimi deri në rakordimin e plotë të detyrimeve.

MMSR me shkresën nr.6776 prot, datë 31.12.2014, kërkesë për akordim të fondit të detyrimeve të prapambetura, drejtuar ██████ Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Financave, lidhur me pretendimet e ██████, shprehet: “Në lidhje me detyrimet, ndërmjet ish MPÇSSHB dhe ██████ është rakorduar për periudhën Korrik 2008- Maj 2012. Në fund të rakordimit, nga pretendimi total i ██████ prej 98,518,147 lekë, është pranuar e paguar nga ish MPÇSSHB, detyrimi prej 51,206,371 lekë, shumë e akorduar me VKM nr.876, date 12.12.2012. Për diferencën 47,311,776 lekë, nuk është rënë dakord midis dy institucioneve”. Mbas verifikimeve të grupit të punës, në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga ██████ për periudhën 2001-2007 shuma e rakorduar është 20,455,000 lekë, detyrimi i pretenduar nga ██████ është 77,852,315 lekë. Në kërkesë theksohet se, shuma e rakorduar për periudhën 2001-2007, përfaqëson rastet e verifikuara plotësisht sipas dokumentacionit vërtetues të paraqitur në ██████ sh.a

-Nisur nga kjo shkresë drejtuar Ministrisë së Financave konstatuam se, detyrimi i referohet periudhës së viteve nga 2001 deri në 2007, ndërkohë që pagesa e kryer citon detyrimin për periudhën 2001-2008, për të cilën MMSR ka kërkuar nga Ministria e Financave shumën 20,455,000 lekë.

-Nuk është zbatuar pika 3/b e urdhrin të Ministrit nr.242, date 17.12.2014, lidhur me afatet e përcaktuara për llogaritjen e detyrimeve. Urdhri kërkon saktësimin e detyrimeve për periudhën Qershor 2001- Qershor 2008 dhe Maj 2012- Korrik 2012.

-Shuma e njohur nga ana e MMSR, e detyrimit ndaj [REDAKTUAR] është kryer jo sipas të dhënave të financiare ligjore të MMSR-së dhe gjithashtu në institucion nuk u gjenden dokumente si pasqyra financiare ndër vite të certifikuara nga eksperte ligjore të [REDAKTUAR] për të saktësuar dhe provuar këtë detyrim ndër vite, (mungojnë edhe llogaritë e detyrimeve e marra përsipër në momentin e privatizimit).

Nga auditimi i likuidimeve përmes thesarit konstatoam se gjatë vitit 2014, janë bërë pagesa të lidhura me detyrime të prapambetura për shpenzime telefoni ndaj operatorit [REDAKTUAR], vlera 502,300 lekë e konstatuar nuk është materiale por përshkrimi i referohet detyrimeve në vite. Kështu me shkresën nr.2723 prot, datë 30.03.2015, nga [REDAKTUAR] është pretenduar shuma 141,048 lekë (për tel. nr.35542233429, sipas dokumenteve nga 31.07.2012 deri më 31.12.2013), me shkresën nr.496 prot, datë 21.01.2015, është pretenduar shuma 26,395 lekë (kontrata nr.1301041043, fatura nr.11907532, datë 31.07.2009, detyrimi 26,395 lekë si dhe kontrata nr.1301047999, 13 fatura nga datat 30.04.2010 deri më 30.04.2012). Me shkresën nr.733 prot, datë 28.01.2015, është pretenduar shuma 16,603 lekë (kontrata nr.1301048713, nr.35542261416, dy fatura datë 30.04.2010 dhe 30.04.2011), si dhe shuma 14,721 lekë (kontrata nr.1301048713, nr.35542261416, dy fatura datë 30.04.2010 dhe 30.04.2011).

Nga auditimi u konstatua se në pasqyrat financiare të institucioneve (ish MPCÇS apo të Shërbimit Social Shtetëror) nuk ka të dhëna për detyrimet e mbartur në vite ndaj [REDAKTUAR] për pagesat e shpenzimeve telefonike për personat me aftësi të kufizuar dhe gjithashtu nuk ka të dhëna në formën e një date-baze për numërim sipas emrave dhe rretheve të personave me aftësi të kufizuar ndër vite. Nuk na u vu në dispozicion asnjë marrëveshje, ndërmjet [REDAKTUAR] dhe MMSR për njohjen e detyrimit ndër vite, theksojmë se [REDAKTUAR] sh.a është privatizuar në bazë Ligjit nr.9785, datë 19.07.2007 “Për ratifikim e kontratës për blerjen e aksioneve të [REDAKTUAR].”

Detyrimet e prapambetura janë shlyer në referencë të VKM nr.50, datë 05.02.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimt”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5 datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, ku cilësohet “*konsiderohen detyrime të prapambetura, detyrimet financiare të përcaktuara nga një ligj/kontratë/marrëveshje/vendim gjykate i formës së prerë që mbeten të papaguara 30 ditë pas datës së specifikuar në kontratë apo me ligj. Ndërsa në referencë të pikës 2 të këtij theksohet se...procedurat e detajuara në këtë udhëzim do të ndiqen vetëm për shlyerjen e detyrimeve financiare të prapambetura që figurojnë si të tilla në pasqyrat financiare të vitit 2013 të njësisve të të gjitha niveleve të qeverisjes qendrore, vendore (për financimet nga fondi i zhvillimit rajonal) dhe fondet speciale, të korrigjuara me pagesat e kryera gjatë muajit Janar 2014. Detyrimi i paguar [REDAKTUAR] nuk figuron në pasqyrat financiare si në MMSR dhe në Shërbimin Social Shtetëror deri më 31.12.2013 e në vazhdim. Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, i ndryshuar, në pikën 21 përcakton qartë se “*Nëpunësit autorizues të njësisve të qeverisjes qendrore e vendore sigurohen që të gjitha urdhrat e pagesës të paraqitura në degën e thesarit respektiv, të jenë të shoqëruara me dokumentacionin e plotë justifikues të shpenzimit të kryer*”.*

Gjithashtu konstatoam që sipas VKM nr.404, datë 20.06.2012 “Për përcaktimin e masës se kritereve e të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar, nga personat me statusin e të verbrit dhe invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik për faturën e energjisë dhe faturën e telefonisë fikse”, sipas pikës 4 thuhet se individët përfitues së statusit sipas ligjit nr.8626, datë 22.06.2000 “Statusi i invalidit, praplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar u jepet kompensim për faturën e telefonisë fikse në masën 1,000 lekë në muaj. Në mënyrë që ta përfitojnë këtë individët duhet të paraqesin në njësitë e qeverisjes vendore dokumentacionin përkatës të përcaktuar në pikën 8 të kësaj VKM. Efektet financiare për vitin 2012 të përballohen nga fondet e miratuara për MPCSSH. Sipas kësaj VKM, pika 12 e VKM nr.83, datë 26.02.2001 shfuqizohet.

VKM nr.850, date 17.12.2004 “Për disa ndryshime në VKM nr.83, date 26.02.2001 “Për tarifat telefonike dhe për pagesat e energjisë elektrike nga personat me aftësi të kufizuara” i ndryshuar. Trajtuar më hollësisht në faqen nr.48-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

MMSR të pezullojë menjëherë çdo pagesë lidhur me pretendimet ndër vite të [redacted], deri në saktësimin e detyrimeve bazuar në fatura individuale dhe me nivel impulsesh të konsumuara, të analizojë përgjegjësitë individuale të personave të ngarkuar për hartimin e Akt Rakordimit nr.6483/1 datë 31.12.2014.

Ministria e Financave nëpërmjet Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik të kryejë inspektimin e dokumentacionit vërtetues të detyrimit për pagesat e kryera nga MMSR për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura ndër vite ndaj [redacted] dhe të përcaktojë përgjegjësitë në vite për lejimin e kësaj shtate, mos reflektimit të detyrimeve në pasqyrat financiare të Institucionit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

2. Nga auditimi i financimeve të huaja për periudhën 2014-2015 në MMSR rezultojnë të identifikuar në formë grandi gjithsej 20 projekte dhe një kredi nga Banka Botërore. Më total MMSR është përfituese e një vlere të përafërt 10 milion Euro nga donatorë të ndryshëm të BE si dhe rreth 14 milion CHF (franga zvicerane) akorduar nga Qeveria Zvicerane nëpërmjet marrëveshjeve ndërqeveritare. Kredia e Bankës Botërore me objekt “Modernizimi i Asistencës Sociale” është në vlerën 38 milion Euro. Konstatuam se në Ministri nuk disponohej asnjë dokumentacion mbi aktivitetin e kryer nga këto projekte, përveçse ndonjë raporti përfundimtar ose të ndërmjetëm pavarësisht se MMSR është përfituesi i këtyre grandeve të akorduara Shtetit Shqiptar.

MMRS që nga krijimi i saj, duke qenë se mbulon problematikën dhe pjesën vulnerabel të shoqërisë shqiptare, është asistuar ndër vite me fonde të donatorëve të cilët janë dhënë në formë financiare, teknike apo dhe në natyrë. Lidhur me këto projekte pavarësisht kërkesës dhe insistimit të grupit të auditimit, rezultoi se Ministria dispononte vetëm një tabelë përmbledhëse të tyre dhe nuk është në gjendje të identifikojë përdorimin financiar lidhur me objektivat të cilat duhet të arrihen nëpërmjet financimit të tyre, nuk ishte në gjendje të identifikonte qartë se ku dhe si këto projekte menaxhohen, sa në përputhje ishin ato me Strategjitë Kombëtare dhe sa të identifikuar në përfitues ato janë. Në periudhën që u krye ky auditim, është pothuajse e pamundur të identifikohet një projekt i caktuar, produkti i tij dhe target grupi i përfituesve, për te pasur mundësi krahasimi nëse këto projekte përputhen me procedurat e sistemit të planifikimit të integruar (SPI) si kuadri kryesor kombëtar për hartimin e politikave dhe planifikimin financiar dhe alokimin e burimeve të brendshme e financimeve të huaja. Nuk mund të evidentojmë nëse përparësitë për financimin e huaj, janë bazuar në përparësitë e programit qeveritar dhe Strategjitë Kombëtare për zhvillim dhe integrim, strategjive sektoriale e ndërsektoriale dhe planit kombëtar për integrimin e vendit në BE.

Pra MMRS nuk ka një memorje institucionale bazuar në të dhëna të plota për çdo projekt dhe produktet e përfituara prej tij. Mungesa e një “memorie” të tillë rrit riskun e përsëritjes së të njëjtave projekte me produkte të ngjashme që ndryshojnë vetëm nga terminologjia.

Nga auditimi dhe verifikimi i të dhënave në Ministrinë e Financave, rezulton se nga MMSR është raportuar vetëm projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale me fonde të Bankës Botërore si dhe TVSH dhe Taksë doganore paguar për Projektin RISI Albania dhe Projektin GIZ, dhe nuk ka të raportuar asnjë nga grandet e përfituara nga donatorët e ndryshëm megjithë vlerat e konsiderueshme, veprim ky që është në kundërshtim me kërkesat e pikës 20 të VKM nr.775 datë 24.09.2010, ku “Ministritë/institucionet qendrore dhe vendore, kur përfitojnë ndihmë financiare apo materiale nga fondacione, shoqata, ndërmarrje, individë të ndryshëm etj., detyrohen që menjëherë, të raportojnë në Ministrinë e Financave. Mosraportimi në kohë ngarkon me përgjegjësi drejtuesin e institucionit dhe i jep të drejtë Ministrisë së Financave të rishikojë deri në pakësimin e fondeve buxhetore të kushtëzuara për vlerën e ndihmës së përfiturar”. Ndërsa në pikën 21 përcaktohet: “Ministritë/institucionet qendrore dhe vendore, kur përfitojnë për projekte të ndryshme hua, grante apo ndihma materiale, rregullisht një herë në muaj, sipas afateve, raportojnë të dhënat në Ministrinë e Financave.”

Nga auditimi konstatohet se grandet dhe projektet, jo vetëm nuk raportohen por edhe nuk regjistroheshin në fund të vitit si të hyra apo si pjesë e buxhetit faktik vjetor, pavarësisht se grandet janë të hyra në Buxheti e Shtetit në ndihmë dhe mbështetje të Shtetit Shqiptar ku në bazë të

informacionit të MMSR, Ministria e Financave ndjek, regjistron dhe raporton të gjitha transaksionet që lidhen me huat dhe grandet, referuar VKM nr.775 datë 24.09.2010 ku realizimi i huave dhe grandeve nga jashtë do të jenë pjesë përbërëse e buxhetit faktik vjetor si dhe do të ndiqet procedura e parashikuar në pikën 18 të tij ku: “Të gjitha të ardhurat nga huat dhe grantet do të regjistrohen si të hyra në “Llogarinë qendrore të thesarit”, në Bankën e Shqipërisë, nëpërmjet tranzitimit në llogaritë speciale të hapura në emër të çdo projekti pranë Bankës së Shqipërisë. Huat dhe grantet që lëvrohen në natyrë, për shkak se pagesa e tyre bëhet drejtpërdrejt nga llogaritë e huadhënësit, do të regjistrohen si të hyra në buxhet, në bazë të njoftimeve të pagesave nga huadhënësi/dhuresi dhe të konfirmuara nga institucioni përfitues, sipas procedurave që do të përcaktojnë për këtë qëllim Ministria e Financave”. Nga ana tjetër vlera e këtyre grandeve mungon edhe në pasqyrat financiare të Institucionit i cili është dhe përfitues i tyre, kjo denatyrizon të dhënat e pasqyrave financiare dhe raportimin financiar.

MMSR për projektet e grandeve ka nënshkruar marrëveshje midis saj si Institucion përfitues dhe Donatorëve të ndryshëm. Bazuar në dokumentacionin që kishim në dispozicion konstatohet se këto marrëveshje e vendosin pozicionin e Ministrisë pothuaj in-ekzistent dhe të padukshëm në administrimin dhe përdorimin e tyre drejt destinacionit të përcaktuar duke e transferuar kompetencat e veta tërësisht drejt donatorëve dhe palëve të treta. Këto marrëveshje e minimizojnë rolin e përfituesit (që është Ministria), duke e pozicionuar rolin e tij në pjesëmarrjen dy herë në vit në mbledhje të bordeve, pa të drejta vetoje mbi ndryshimin apo përqasjen e objektivave të ndryshme, apo dhe nevojave reale që ekzistojnë. Në këto marrëveshje, bihet dakord që në shumicën e rasteve administrimi i këtyre fondeve të kryhet nga palë të treta (OJF), nën monitorimin e donatorëve, siç është rasti i RISI Albania, (apo dhe të tjerë) ku projekti menaxhohet jashtë Ministrisë dhe nuk ka asnjë informacion financiar lidhur me komponentët e projektit dhe shumat përkatëse të financimit (kjo mungesë e aneksit financiar konstatohet dhe në relacionin dërguar Këshillit të Ministrave për Miratimin e Marrëveshjes).

Miratimi i marrëveshjes për RISI Albania nga ana procedurale është në kundërshtim me VKM nr.775 datë 24.09.2010 “Për administrimin e Financimeve të Huaja në Republikën e Shqipërisë”, pasi është një projekt i importuar nga vetë Ministria dhe është dërguar për miratim në KM ndërkohë që sipas pikës 11 të VKM nr.775 datë 24.09.2010 “Për administrimin e Financimeve të Huaja në Republikën e Shqipërisë” është Ministria e Financave institucioni i vetëm që ka të drejtën të kërkojë dhe sigurojë financime nga huadhënësit dhe dhuresit në formën e huave dhe granteve dhe ky proces kryhet nga DEBASKON-i (sot DZHFNH) në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Integritit.

Nga auditimi i raporteve të financimit (të cilat patëm mundësi të auditoheshin nga grupi i auditimit), konstatuam se shumica e komponentëve të tyre e shpenzojnë janë kosto stafi apo ekspert të cilët janë shumë të shtrenjtë në honorare, për një vend në zhvillim si vendi ynë, dhe për komunitetin të cilit ky projekt po ju vjen në ndihmë, kështu pagat e stafit kalojnë nivelin mesatar të një page në Shqipëri apo pjesëmarrësit e një konference paguhen për pjesëmarrjen e tyre me 180 Euro dita ose tarifa ekspertësh apo studime të cilat janë në shifra të konsiderueshme apo një drekë evenimenti e cila kushton 6000 euro në shpenzime të ekzagjeruara dhe në kontrast të thellë me komunitetin për të cilin projektet realizohen. Trajtuar më hollësisht në faqen nr. 55-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

### ***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë nëpërmjet Drejtorisë së Integritit të marrë masa të menjëhershme për grumbullimin e informacionit dhe hedhjen në database e ngritur prej saj, për çdo projekt lidhur me aktivitetet në formë produkti për çdo objektiv të parashikuar në marrëveshjet e projekteve, përdorimit financiar dhe përfituesit e tyre.

Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë nëpërmjet Drejtorive përkatëse sipas natyrës së çdo projekti të bëjë një analizë të detajuar nëse objektivat e deritanishme të vendosura nga Projektet të cilat po implementohen, janë në përputhje me programet qeveritare dhe Strategjitë Kombëtare për zhvillim dhe integrim, strategjive sektoriale e ndërsektoriale dhe prioritetet e vendosura nga vetë Ministria, si dhe planit kombëtar për integrimin e vendit në BE. Në përfundim të analizës së mësipërme të ndërmarrë takime me të gjithë donatorët për rishikimin dhe riformatimin e mundshëm të atyre projekteve të cilat përfaqësojnë të tyre i kanë larg Strategjisë Kombëtare dhe prioritetet e vendosura nga vetë Ministria. Mundësia e rishikimit të këtyre marrëveshjeve duhet të lidhet edhe me rolin e Ministrisë në implementimin e projekteve dhe realizimin e objektivave për të cilat donatorët dhurojnë donacione të formave të ndryshme shtetit Shqiptar.

Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë nëpërmjet Drejtorisë së Financës dhe çdo Drejtori të aparatit të saj të cilat janë të përfshira në projekte të ndryshme, menjëherë të raportojnë në Ministrinë e Financave, mbi projektet e përfutuara në formë të ndryshme hua, grande apo ndihma materiale.

Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë të ndërmarrë takime me të gjithë donatorët me qëllim qartësimin mbi procedurat e financimit të projekteve sipas VKM nr.775 datë 24.09.2010 ku Realizimi i huave dhe grandeve nga jashtë do të jenë pjesë përbërëse e buxhetit faktik vjetor si dhe do të ndiqet procedura e parashikuar në pikën 18 të tij ku: *“Të gjitha të ardhurat nga huat dhe grantet do të regjistrohen si të hyra në “Llogarinë qendrore të thesarit”, në Bankën e Shqipërisë, nëpërmjet tranzitimit në llogaritë speciale të hapura në emër të çdo projekti pranë Bankës së Shqipërisë. Huat dhe grandet që lëvrohen në natyrë, për shkak se pagesa e tyre bëhet drejtpërdrejt nga llogaritë e huadhënësit, do të regjistrohen si të hyra në buxhet, në bazë të njoftimeve të pagesave nga huadhënësi/dhuruesi dhe të konfirmuara nga institucioni përfutues, sipas procedurave që do të përcaktojnë për këtë qëllim Ministria e Financave.”* Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë të mos ndërmarr hapa për nënshkrimin e marrëveshjeve në të ardhmen me donatorë të ndryshëm pa bashkëpunuar më parë me Ministrinë e Financave e cila është institucioni i vetëm që ka të drejtën të kërkojë dhe sigurojë financime nga huadhënësit dhe dhuruesit në formën e huave dhe granteve, si dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Integritit.

MMSR të marrë masa të menjëhershme që lidhur me projektin RISI Albania, (apo dhe të tjerë) ti kërkohej donatorit mundësia e rishikimit të marrëveshjes dhe lidhur me raportimin financiar dhe të objektivave, rishikimin e rolit të MMSR në implementimin dhe realizimin e objektivave të projektit.

Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë gjatë nënshkrimit të marrëveshjeve dhe miratimit të raporteve financiare të ushtri kompetencat dhe rolin e saj vendimtarë që financimet të orientohen drejt shpenzimeve të objektivave, kostot lokale të jenë të pranueshme në nivelin e parashikuar si të çdo punonjësi administrate në Shqipëri apo nivelit të pagës të miratuar nga Këshilli i Ministrave, ku të këtë një disiplinim dhe menaxhim efektiv të këtyre fondeve dhe jo shpenzime të ekzagjeruara që kapërcejnë çdo limit tolerance të pranueshëm në kontrast të thellë me komunitetin për të cilin ky projekt realizohet.

Të regjistrohen në kontabilitet të gjitha marrëveshjet sipas të cilave Ministria përfiton fonde, ndihma apo grande, bazuar në standardet e kontabilitetit publik.

### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**3.** Nga auditimi i programimit për vitin 2014, konstatoam se PBA e Ministrisë është dërguar në Ministrinë e Financave për fazën e parë me shkresën nr.562/7 datë 29.04.2013 dhe faza e dytë me shkresën nr. 562/14, datë 28.08.2013, brenda afateve të përcaktuara në ligj. Me ligjin nr. 185/2013, datë 30.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014”, Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë i janë akorduar fonde në shumën totale 72,820,760 mijë lekë. Krahasuar me fondet e çelura në fillim viti, rezulton se ky institucion për vitin 2014 ka pasur ndryshime në të konsiderueshme të fondeve në programin “Mbështetje për Kultet Fetare (institucione varësie të MMSR)”, pasi janë alokuar fonde në formë transferte kapitale për pagesën e prapambetur të rikonstruksionit të Kryegjyshit të Botërore të Bektashinjve sipas Aktit Normativ Nr.1, datë 17.09.2014. Në fund të vitit me mos realizim paraqiten programi “Rehabilitimi i të Përndjekurve Politikë”, realizuar vetëm në masën 82%, programi

“Punësim Formim Arsim Profesional” realizuar në masën 89% dhe programet “Inspektimi në Punë” dhe “Përfshirja Sociale” realizuar vetëm 92%, theksojmë se realizmi është krahasuar me planin përfundimtar se po ti referoheshim planit fillestar mosrealizmi do të ishte në nivel më të lartë. Fondet për investime çelur për vitin 2014 për këtë Ministri ishin në vlerën 961,500 mijë lekë. Referuar planit përfundimtar ky zë paraqitet me realizim në masën 96%.

Për vitin 2015, PBA e Ministrisë është dërguar në Ministrinë e Financave për fazën e parë me shkresën nr.1233/5 datë 30.04.2014 dhe për fazën e dytë me shkresën nr.1233/16, datë 28.08.2014, brenda afateve të përcaktuara në ligj. Për vitin 2015, kemi shtesë të një programi buxhetor për shkak të kalimit të Shkollave të Mesme të Arsimit Profesional, kaluan në varësi të MMSR në bazë të ligjit nr.63/2014 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8872, datë 29.03.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”, i ndryshuar. Nën programin “Arsimi i mesëm profesional” janë alokuar fonde për menaxhimin e 41 shkollave profesionale. Në zbatim të ligjit nr.160, datë 27.11.2014 “Për buxhetin e vitit 2015” fondi i akorduar për MMMSR është në shumën 76,163,970 mijë lekë, ku fondet për programet për “Sigurimet shoqërore” dhe “Përkujdesi social” zënë përkatësisht 58.7% dhe 32,6 % të totalit të fondeve të gjithë Ministrisë.

Gjatë vitit 2015, fondet e programuara kanë pësuar ndryshime: Me VKM nr.414, datë 13.05.2015 janë transferuar në programin “Përfshirja Sociale”, shuma prej 35,000,000 lekë për projektin e rinisë “Endra ime”; me VKM nr.453, datë 27.05.2015 në programin “Planifikim, menaxhim, administrim”, shuma 100,000,000 lekë për projektin “Sandexhidio”, me VKM nr.758, datë 16.09.2015 janë akorduar fonde në programin “Përkujdesi Social ” në shumën 170,000,000 lekë për blerjen e dekoderave për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike, me VKM nr.1083 datë 28.12.2015 në programin “Përkujdesi social” transferuar shuma 304,000,000 lekë për shpërbllimin e fundit të vitit për familjet me ndihmë ekonomike dhe personat me pagesë paaftësie si dhe vlera 1,238,000,000 lekë për shpërbllimin e pensionistëve në programin “Sigurimi shoqëror”. Realizimi i buxhetit për vitin 2015, krahasuar me planin përfundimtar referuar akt-rakordimeve, paraqitet si më poshtë:

*në mijë/lekë*

Emërtimi i programit	Programimi sipas PBA	Ligji nr.160, datë 27.11.2014	Plani përfundimtar	Realizimi faktik
Plan.Men.Admin	198 200	178 100	289 038	261 466
Sigur. Shoqëror	51 259 000	47 060 000	41 849 408	41 847 298
Përkujdesi Social	24 667 809	22 449 623	23 233 124	22 690 732
Tregu i Punës	2 378 603	2 057 011	1 867 401	1 622 231
Inspek ne Pune	281 224	199 624	205 877	184 688
Përfshirja Sociale	100 963	103 150	118 841	90 520
Mbështetja për Kultet Fetare	129 709	128 900	218 570	214 406
Rehabilitimi Përndjekurve Politikë	3 050 700	2 036 300	2 036 970	1 999 658
Arsim i Mesëm Profesional	1 951 262	1 951 262	1 462 846	1 376 952
<b>TOTALI</b>	<b>84 017 470</b>	<b>76 163 970</b>	<b>71 282 075</b>	<b>70 287 951</b>

Investimet kapitale pavarësisht programimit në nivelin 1,429,444 mijë lekë në PBA, për vitin 2015 janë planifikuar në shumën 973,400 mijë lekë, plan i cili është ndryshuar duke u ulur në nivelin 540,014 mijë lekë. Në fund të vitit rezulton se investimet si MMRS janë realizuar në masën 82% ose në vlerë 443,137 mijë lekë. Konstatohet se në llogarinë 231 (investime) përfshihet shuma 15,444,918 lekë, për rimbursimin e TVSH-së të 5 programeve të bashkëpunimi ku MMSR është përfituese, konkretisht a) Programi për zhvillimin e burimeve njerëzore /arsimi dhe formimi profesional (GIZ), b) Funkionimi i tregut të punës për të rinjtë (Risi Albania), c) Fuqizimi i komuniteteve vulnerable lokale (PNUD), d) Europa për qytetarët UNDP, dhe IPA), e) Projekti IPA Komisioni European për ndërtimin e 3 shkollave. Trajtuar më hollësisht në faqen nr. 16-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

### ***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Nga MMSR gjatë hartimit dhe planifikimit të fondeve, sipas çdo programi, me qëllim shmangien e ndryshimeve në nivele të larta të fondeve për çdo produkt në programet që kjo Ministri kërkon të

realizojë. Duhet që të ketë një programim të kujdesshëm të objektivave/produkteve të cilat do të sjellin kërkesa buxhetore të qarta, shoqëruar me programimin e kujdesshëm të fondeve të buxhetit si në kuadër të buxhetimit afatmesëm dhe atë vjetor.

*Në vijimësi*

4. Nga auditimi konstatohet se, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR) nuk ka hartuar dhe dorëzuar në Ministrinë e Financës përmbledhësen e pasqyrave financiare për vitin 2014 dhe 2015, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.9248, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, të VKM nr.248, datë 10.04.1998, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 26, datë 27.12.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.14, datë 28.12.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e Pasqyrave Financiare Vjetore të vitit 2007 për institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe njësisve që varen prej tyre si dhe njësisve të menaxhimit/zbatimit të Projekteve e Marrëveshjeve me Donatorë të Huaj” dhe të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.28, datë 18.12.2014.

Në pasqyrat financiare rezultojnë se institucioni ka debitorë të pa arkëtuar ndër vite për ish punonjës të larguar, detyra të lëna nga KLSH-ja por aktualisht nuk kanë filluar arkëtimi i tyre në shumën 24 203 lekë, dhe shuma prej 291 498 lekë e cila i përket dy subjekteve private për të cilat institucioni ka hapur çështje gjyqësore, është me shpresë arkëtimi pasi ky detyrim është në Zyrën e Përmbartimit Tiranë për ekzekutim. Në pasqyrat financiare të institucionet nuk rezultojnë të pasqyruara detyrimet për vendime gjyqësore ndaj ish punonjësve. *Trajtuar më hollësisht në faqen nr.103-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

#### ***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, të marrë masa të menjëhershme për hartimin e Pasqyrave përmbledhëse financiare të konsoliduara në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë fushën e kontabilitetit dhe dorëzimin e tyre në Ministrinë e Financave. Të shikohet ky si një proces jo formal i hartimit të këtyre pasqyrave por të ketë një kontroll dhe raportim të pasqyrave të hartuara nga njësitë e varësisë.

Të merren masa që Drejtoria e Financës, të evidentojnë, të rakordojnë të gjitha detyrimeve që rezultojnë gjendje në Bilancin e institucionit më datë 31.12.2015 dhe në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të kryejë ndjekjen dhe arkëtimin e detyrimeve duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi. Të merren masat që detyrimet e çdo lloji të pasqyrohen me vërtetësi në pasqyrat financiare.

Njësia e Auditit të brendshëm të ndjek dhe kontrollojë procesin e konsolidimit të pasqyrave financiare të gjithë njësisve të varësisë së Institucionit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

5. Nga auditimi për prokurimin me objekt **“Rikonstruktion, kthim në Qendër Rinore, Tiranë”** realizuar me procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim” gjatë vitit 2014, me vlerë të prej 5,898,793 lekë pa TVSH, rezultoi se;

-Investimi është realizuar në ambientin prej 369 m<sup>2</sup>, e marrë në përdorim në bazë të Kontratës Huapërdorjes (pa qira) të datës 30.04.2014, e nënshkruar nga MMSR me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë, me afat të përdorimit të pacaktuar. Vlera e investimit nuk del në vlerën kontabël të godinës, pasi figuron në administrim të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, kjo në kundërshtim me ligjin nr.9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 6 dhe Udhëzimin nr.30 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pjesa III (Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre) pika 26, 28 dhe 30.

-Leja e ndërtimit është marrë më vonë se janë zhvilluar procedurat e prokurimit dhe likuidimit të situacionit pjesor, (leja e ndërtimit datë 25.01.2015, prokurimi është zhvilluar në datën 10.11.2014) si dhe investimi ka mbaruar në datën në datën 13.01.2015 sipas shkresës nr.5445/13 nga shoqëria “Klajger Konstruksion” shpk drejtuar Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, kjo në kundërshtim me ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”; me Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr.2 datë 13.05.2005, i ndryshuar pika 3.1 ku thuhet se *“Menjëherë pas nënshkrimit të kontratës, në kushtet dhe afatet e përcaktuara, investitori (MMS&R) dorëzon*

sipërmarrësit (Shoqërisë ■ në original; a) dokumentacionin administrativo-ligjor për truallin dhe sheshin e ndërtimit; b) lejen e ndërtimit.....’

-Është lidhur kontrata e sipërmarrjes nr.5445/1 datë 15.12.2014 midis MMSR dhe shoqërisë ■. Ndërkohë më datë 24.12.2014 është mbajtur proces-verbal i nënshkruar nga investitori (MMSR) e përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm ■, sipërmarrësi i punimeve shoqëria ■ e përfaqësuar nga administratori ■ dhe mbikëqyrësi i punimeve ■, të cilët kanë shprehur kërkesën për shtesë fondi i specifikuar në preventivin e punimeve si dhe në relacionin teknik shpjegues, me vlerën prej 5,100,000 lekë (vlerë kjo mbi 80% të vlerës së prokuruar). Ky veprim është ndërmarrë në kundërshtim me ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimet publike” i ndryshuar, neni 24 pika d dhe neni 33, pika 5/b. Nisur nga këto kushte, Autoriteti kontraktor duhej të anulonte këtë procedurë dhe të zhvillonte procedurë të re. Gjithashtu, vihet re se ndryshimet e bëra në zërat e punimeve, nuk janë të shoqëruara me relacion tekniko-ekonomik nga projektuesi (UNDP), konkretisht kapitulli preventiv punime pjesa C me vlerë prej 3,010,426 lekë pa TVSH, i pa shoqëruar me relacion tekniko-ekonomik nga projektuesi (UNDP) dhe pa miratimin nga projektuesi, procedurë në kundërshtim ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimet publike” i ndryshuar, ligjin nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”. Rezulton se kjo “shtesë kontrate” është mbuluar me fonde të sponsorizuara sipas Kontratës së Sponsorizimi nr.3129 datë 29.01.2015 midis ■.Bank sh.a dhe Shërbimit Kombëtar për Rininë, ndërkohë që investimi ka mbaruar në datën 13.01.2015.

-Konstatohet se vlera prej 5,100,000 lekë nuk ka kaluar nëpërmjet thesarit, veprim në kundërshtim ligji nr.7892 datë 21.12.1994 “Për sponsorizimit” neni 4. Trajtuar më hollësisht në faqen nr.69-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

#### ***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Autoriteti Kontraktor, MMSR-së, të marrë masa për zbatimin e saktë të procedurave të lidhura me prokurimin e objekteve pavarësisht faktit se me çfarë fondesh mbulohen investimet. Të analizohen shkaqet e shkeljeve të lidhura me kërkesat e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontabilitetit publik në procedurën e trajtuar më sipër. Gjithashtu, AK të mos realizojë investime mbi objekte të cilat nuk i ka në pronësi të vet, ose për të cilat nuk ka garanci kontraktuale që do të jenë në përdorim për sa kohë investimi do mbulojë veten. Të ndërpriten praktikatat e fillimit të procedurave të tenderimit pa siguruar marrjen e lejes së ndërtimit nga institucionet përkatëse, të cilët duhet të jenë pjesë e dokumenteve të dosjes së prokurimit.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

#### **6. Nga auditimi i tenderit “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike të objektit dhe ambienteve rrethues të MMSR”, nëpërmjet tre procedurave janë vërejtur mangësi:**

-*Procedurë I e anuluar*, NjHD, nuk ka kërkuar shprehimisht ndërlidhjen e ofertës me elementët e saj (preventivi/analizë/kosto), por ka kërkuar një ofertë në të cilën përfshihen të gjitha shpenzimet dhe detyrimet fiskale, kjo në kundërshtim me nenin 23 (Specifikimet teknike) pika 1, të LPP-së. Ky fakt, ka sjellë konfuzion në mënyrën e ofertimit nga ana e operatorëve ekonomikë, ku një pjesë e operatorëve pjesëmarrës kanë ofertuar në total, kurse disa të tjerë kanë paraqitur edhe analizë kostoje. Për rrjedhojë ka pasur disa ankesa nga OE pranë KPP-së, i cili ka vendosur, me vendim nr.137/2014 të datës 11.04.2014, që autoriteti kontraktor, të anulojë procedurën e prokurimit, duke e rishpallur me korrigjimet në shkeljet e konstatuara.

-*Procedura II “Kërkesë për propozim”*, nga s’kualifikimet e operatorëve ekonomikë nga KVO-ja, ka pasur ankesa në KPP, i cili me vendimin nr.376/2014 datë 09.07.2014, i ka kërkuar autoritetit publik të MMSR, të rikuafikojë OE ■ dhe të s’kualifikojë të gjithë OE pjesëmarrës të kualifikuar. Ky vendim i KPP-së nuk është zbatuar nga AK i MMSR, kjo në kundërshtim me ligjin nr.9643 datë 20.12.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 19/1 në pikën 2, gjithashtu në bazë të nenin 64/2 (Vendimet e KPP), pika 2, ku në rast të moszbatimit, duhet të ankimonte vendimin e KPP pranë gjykatës administrative, gjë të cilën nuk e ka bërë. Procedurë e II-të, është anuluar nga MMSR, me arsyetimin se është konstatuar se ka gabim në llogaritjen e fondit limit. Ky justifikim duket joserioz, në rrethanat mbi të cilën është zhvilluar procedura.

Vlerësojmë, se kemi dy momente për të cilat AK ka vepruar në kundërshtim nga ana e procedurave duke mos respektuar ligjin e LPP-së, momenti i parë, AK nuk ndodhet në asnjë nga kushtet e për anulimin e procedurës II, në kundërshtim të ligjit nr.9643, datë 20.12.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, kreu IV (llojet dhe përzgjedhja e procedurës) pika 5/a dhe **momenti i dytë** mos respektim të procedurave të procedurave prokuruese në kundërshtim të plotë me ligjin nr.9643 datë 20.12.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 19/1 në pikën 2 përcaktohet se “Komisioni i Prokurimit Publik, në përfundim të shqyrtimit të ankesave, merr vendime, të cilat janë administrativisht përfundimtare”, në nenin 64/2 (Vendimet e KPP), pika 2. *Trajtuar më hollësisht në faqen nr.72-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Autoriteti kontraktor i MMSR, të marrë të gjitha masat për trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve të brendshme lidhur me procedurat e prokurimit publik, duke theksuar momentet e ankimimit të vendime administrative të Komisionit të Prokurimit Publik.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**7.** Nga auditimi në procedurën e shërbimit ***“Fushata e komunikimit për Reformën në fushën e Sigurimeve Shoqërore”*** e realizuar sipas VKM-së nr.1195 datë 05.08.2008 *“Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve a të reklamave për transmetim nga operatorët radioteleviziv ose botim në median e shkruar, dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore”* me fond prej 6,166,667 lekë pa TVSH nisur në dhjetor të vitit 2014 dhe realizuar në mars të vitit 2015, është vërejtur se nga ana e komisionit të vlerësimit, vlera e prodhimit të spotit nuk është e detajuar me elementët të cilët e ndërtojnë spotin, por është dhënë vetëm një vlerë totale. Konstatohet se publikimi i spotit vetëm në rrjetet sociale nuk është i argumentuar, se në cilat eksperiencë është bazuar për caktimin e vlerës për facebook. Gjykojmë se komisioni i vlerësimit, shoqërinë ■■■ ka shpallur fituese, në kundërshtim me VKM nr.1195 datë 05.08.2008, pika 7, pasi në bazë të auditimit të ekstraktin e regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit me shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, nuk rezulton që është organ i masmedias apo agjenci e specializuar.

AK, ka miratuar në komisionin e vlerësimit 5 anëtarë, tre prej tyre nuk janë specialistë të fushës, kjo në kundërshtim me pikën 8 të VKM së mësipërme (nga auditimi rezulton se asnjë anëtar i komisionit nuk është specialist i fushës). Gjithashtu, *mbikëqyrja e realizimit të kontratës*, është realizuar nga komisioni i monitorimit. Nga dokumentacioni i dorëzuar nga shoqëria ■■■, për pagesën e këtij shërbimi pranë MMSR (e cila deri në momentin që është hartuar ky material nuk është paguar), rezulton, faturimi total i ndarë (pjesa krijimit të spotit dhe publikimi në facebook dhe Twiteer) ku vlera prej 3,210,350 lekë pa TVSH (publikimi në facebook dhe tëiteer), nuk dokumentohet si blerje e hapësirës publicitare tek administratori në faqen facebook, pasi nuk është e dokumentuar me asnjë dokument vërtetues. Hapja e një llogarie (të cilën mund ta bëjë cilido individ dhe të hedh video në të), *nuk justifikon shumën e kërkuar prej 3,210,350 lekë pa TVSH.* Nga ana e komisionit të vlerësimit nuk ka dokument të hartuar ku të shpjegohet dhe argumentohet, pse janë zgjedhur pikërisht këto rrjete sociale dhe cila është mënyra sesi do të realizohet pikërisht ky, publikim. Pra në asnjë moment nuk del parashikimi për blerjen e një hapësire publicitare të rezervuar në këto rrjete. Rezulton se nuk është parashikuar kjo shumë si në vitin 2014 dhe në vitin 2015, në buxhetin e MMSR, kjo në kundërshtim me ligjin e menaxhimit financiar, si dhe nga administrata aktuale nuk është realizuar pagesa e kontratës së mësipërme. *Trajtuar më hollësisht në faqen nr.83-86 të Raporti Përfundimtar të Auditimit.*

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Autoriteti kontraktor të marrë të gjitha masat, për realizimin e atyre shpenzimeve të cilat janë programuar në fillim viti kalendarik dhe për të cilat janë vlerësuar drejtësisht nevojat dhe objektivat që duhet të arrihen. Në rast të nevojave të domosdoshme duhet të ketë një analizë më të

përgjegjshme si të kostove dhe të procedurave për realizimin e këtyre shpenzimeve duke pasur parasysh kërkesat e menaxhimit financiar.

### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**8.** Nga auditimi i procedurës tenderuese për objektin “*Riparim i Automjeteve të Ministrisë Mirëqenies Sociale dhe Rinisë*”, ka kaluar në tre procedura prokurimi, në të cilat janë evidentuar parregullsi në lidhje mbi, mënyrën e përlllogaritjes së fondit limit, janë përcaktuar vetëm emërtesat e shërbimeve, nuk është paraqitur vlera kontabël dhe norma e amortizimit të mjeteve motorike, veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.9228 datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Udhëzimin nr.30 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Nuk rezulton kilometrazhi i realizuar mjeteve për gjatë vitit të mëparshëm, pra nuk argumentohet gjendja reale e automjeteve, në mënyrë që identifikimi i shërbimeve të jetë real.

-Në tre procedurat kemi ndryshim të fondit limit, e për rrjedhojë kemi ndryshime të kërkesave specifike, nuk ka asnjë relacion teknik sesi janë hequr disa shërbime që duhej të bëheshin mjeteve motorike.

-KVO-ja e procedurës I (anulluar) dhe në procedurën e II (anulluar), ka shqyrtuar ofertat me afate të tejzgjatura, në kundërshtim me bazën ligjore të VKM nr.1 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar Kreu VI, pika 1 germa c si dhe Ankesa e operatori ekonomik në procedurën I (anulluar) është shqyrtuar nga MMSR, në tejkalimin të afateve të tejzgjatura të shqyrtimit të ankesës, në kundërshtim me bazën ligjore të VKM nr.1 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar Kreu IX, pika 1 germa d.

-Arsyetimin e realizimit të procedurës III, “*negocim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës*”, nga ana e AK, nuk është bazuar pasi, në VKM nr.1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” Kreu IV, pika 5, thuhet se “*Kur në përgjigje të dy procedurave të njëpasnjëshme mbi ose nën kufirin e ulët monetar nuk është dorëzuar asnjë ofertë apo kërkesë e përshtatshme. Kushtet fillestare të kontratës apo dokumenteve të tenderit nuk duhet të ndryshohen....*”. Në të dyja procedurat I dhe II, kemi ndryshim të kushteve fillestare, pasi nuk kemi të njëjtin fond limit si dhe kemi ndryshim specifikimeve teknike. *Trajtuar më hollësisht në faqen nr.90-94 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

#### ***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Autoriteti kontraktor MMSR të marrë të gjitha masat që procedura e riparimit të makinave, të paraprihet nga një vlerësim i saktë i gjendjes teknike të makinave në mbështetje të pjesës së dokumentacionit teknik dhe financiar për çdo mjet, për të saktësuar domosdoshmërinë e shërbimit dhe llojin e këtij shërbimi.

### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**9.** Nga auditimi i të gjitha objekteve tenderuese për rikonstruksionin e objekteve, blerjen e mallrave dhe kryerjen e shërbimeve për vitin 2014 dhe vitin 2015, të përzgjedhura nga grupi i KLSH-së është konstatuar se në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, si Autoritet Kontraktor, nuk është ngritur Njësia e Prokurimit Publik. Gjithashtu, u konstatua se në disa raste anëtarët e Komisioneve të Vlerësimit të Ofertave (KVO)-ve, nuk janë specialistë të fushës që është prokuruar e cila ka sjellë mangësi në vlerësimin e ofertave nga ana profesionale, në gabime teknike dhe mangësi në përcaktimin e kriterëve të veçanta. *Trajtuar më hollësisht në faqen nr.65-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

#### ***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Autoriteti Kontraktor i MMSR-së, të marrë masa që, në fillim të çdo viti kalendarik të ngrihet Njësia e Prokurimit me anëtarë të trajnuar. Të shmanget fiktiviteti në studimin e tregut për prokurimet për blerje mallra, duke marrë oferta nga ato subjekte që kanë si aktivitet kryesor mallin, shërbimin që do prokurohet. Dokumentet e tenderit të hartohen dhe paraqiten në mënyrë të hollësishme duke argumentuar për çdo kriter të veçantë.

Anëtarët, në grupet e punës për llogaritjen e vlerës së kontratës dhe Komisionin e Vlerësimit të Ofertave (KVO), të përzgjidhen nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, duket të jenë specialistë të

fushës së prokurimit ose të aplikohet marrja e ekspertëve të jashtëm, në përputhje me bazën ligjore të prokurimeve, të vendosen specialistë të fushës përkatëse, sidomos për punimet e ndërtimeve të reja apo rikonstruksionet (specialist të fushës së ndërtimit), me qëllim që të rritet efienca e përdorimit të burimeve dhe fondeve publike në dispozicion të institucionit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**10.** Nga auditimi konstatohet se, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë deri në përfundim të auditimit nuk ka një regjistër të asetëve në tërësi, si dhe regjistër të pronave të paluajtshme në veçanti për të gjithë sistemin dhe as regjistër të pronave të dhëna me qira, duke mos gjetur zbatim kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e njësive në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kreu III. “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”. *Trajtuar më hollësisht në faqen nr.36-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, të marrë masa të menjëhershme për hartimin e këtij regjistri me të gjithë të dhënat, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e njësive në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kreu III. “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**11.** Nga auditimi i dokumenteve për pagesat e detyrimeve të prapambetura të punonjësve të larguar nga puna, në periudhën para vitit 2015, me vendime gjyqësore të formës së prerë, rezulton se 5 ish punonjës të ministrisë dhe njësitë e varësisë, për të cilët është paguar deri tani rreth 15.5 milion lekë, duhet të rikthehen në vendin e mëparshëm të punës ose të ngjashëm me to. Edhe pse në fund të vitit 2015, në MMSR është krijuar dhe funksionon Komisioni i Posaçëm, i cili merret me zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga institucionet e administratës shtetërore, të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit për shërbimin civil”, duhen përsheptuar ritmi për zgjidhjen e këtij problemi. *Trajtuar më hollësisht në faqen nr. 51-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Të rakordohet puna në institucion dhe të bashkëpunohet me Departamentin e Administratës Civile, për sistemimin në vendet e punës apo të ngjashëm, të pesë punonjësve që me vendim gjykate të formës së prerë duhen rikthyer në vendet e tyre të punës, duke shfrytëzuar pozicionet vakante në strukturën e ministrisë apo njësitë e varësisë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**12.** Nga auditimi i dokumenteve lidhur me administrimin e karburantit, rezulton se janë bërë ndryshime në aktet e brendshme nënligjore, të cilat lënë shteg për një keqpërdorim dhe mungesë kontrolli. Në urdhrin e Ministrit nr.198, date 23.11.2012 “Për shpërndarjen, përdorimin e automjeteve dhe konsumin e karburantit”, pika 3 përcaktohet: “Konsumi i karburantit do të dokumentohet me fletë shërbimet që plotësohen nga shoferi, firmosen nga nëpunësi, drejtori/drejtorja që udhëton dhe llogaritet për sasinë e harxhuar konform normativave të miratuara. Për makinat e Kabinetit të Ministrit, fletë-shërbimet do të plotësohen nga shoferi dhe do të firmosen nga Drejtori i Kabinetit. Ky rregull është ndryshuar me urdhrin nr.115, date 8.05.2014 “Për shpërndarjen dhe përdorimin e automjeteve dhe konsumin e karburantit”, në kreun III, pika 6 shprehet: “Drejtuesit e automjeteve në përdorim të plotësojnë sipas formularit nr.2 bashkëlidhur këtij urdhri, me përjashtim të drejtuesit të automjeteve në dispozicion të ministrit”. Ndryshimi i mësipërm, lidhur me mbajtjen e dokumentacionit për harxhimin e karburantit, është në kundërshtim rregullat e përcaktuara në Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. *Trajtuar më hollësisht në faqen nr. 53-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Të bëhen rregullimet e duhura në aktet nënligjore të nxjerrë nga Institucioni, në mënyrë që furnizimi me karburant dhe kontrolli për mënyrën e harxhimit të tij, të jetë sa më i mbikëqyrur dhe i kontrolluar, në përputhje me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave i ndryshuar.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**13.** Në zbatim të VKM nr. 289 datë 14.05.2014 “Për miratimin, në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, për projektin Funksionimi i Tregut të Punës për të rinjtë Risi (Novacion) Shqipëri Faza e Parë, Nëntor 2013-Tetor 2017”, Aparati i MMSR për vitin 2015, ka të planifikuar si bashkëfinancim për këtë projekt, pra Kosto Lokale, Kap. 3, Art. 231 Investime, në vlerën prej 7,860 mijë lekë. Për vitin 2015 është shpenzuar vlera prej 5,940 mijë lekë. Në zbatim të nenit 4, shkronja e, të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave, (zbatuese MMSR) dhe Qeverisë së Konfederatës Zvicerane, të miratuar me Ligjin nr.9801, datë 13.09.2007, MMSR ka paguar si kontribut për të rimbursuar TVSH e shpenzimeve për projektin “Risi Albania” si psh: tvsh fatura energjie, uji, telefoni zyre, shpenzime karburanti për zyrën e projektit, materiale të ndryshme etj. Pra në fakt janë kryer pagesa si tvsh për shpenzime që nuk janë për objekte kapitale (Aktive të Qëndrueshme) veprim i cili e bën të pamundur kontabilizimin dhe evidentimin si shpenzim kapital të këtij produkti. *Trajtuar më hollësisht në faqen nr.55-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Institucioni i MMSR-së, në marrëveshjet e lidhura ndërmjet Donatorëve dhe Qeverisë Shqiptare të përcaktohet që kontributi i palës Shqiptare në formë bashkëfinancimi nëpërmjet kostos lokale apo tvsh të jetë për produkte konkrete e të monitorueshme në mënyrë që të evidentohen në pasqyrat financiare të institucionit.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

## **B.I MASA SHPËRBLIM DËMI**

**1.** Nga auditimi konstatohet se Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë *ka paguar rimbursim të TVSH për projektin Risi Albania*, për vitin 2015, tetë pagesa në shumën **5,940,133 lekë**, të cilat janë paguar dhe miratuar nga thesari, pagesat janë rimbursim i tvsh, kryesisht për shpenzime: Energji elektrike për zyrat e projektit, shpenzime telefonie të zyrës së projektit, materiale zyre, pagese sigurimi shëndeti për punonjësit e zyrë së projektit, blerje kompjuterësh, materiale konsumi zyre.,ujë për zyrën e projektit, darka pune , dreka , coffee break, fotokopje, ëorkshope, pagesë eksperti 16 080 Euro, aktivitet fokus grup, etj, shërbim sipas kontratës në vlerë 1,536,000 lekë , shërbime Rafting +akomodim+darke+ hiking ne Berat, për 11 persona në vlerën 900 Euro, shërbim kokteji për 50 persona, studim balanca gjinore mbi afrimin e informacionit të tregut të punës nëpërmjet medias në Shqipëri (32 ditëx200) euro=6400 euro, shërbim auditimi 3600 euro, trajnim i paketës fiskale 156 euro.etj pagesa Top chanel 2,256, 000 lekë ose shërbime sipas kontratës mars 2015 po me tv ■ në shumën 1,776,000 lekë , me Tv ■ për 4 emisione “ drejt punës” në vlerë 198 000 leke, *pa asnjë dokumentacion shoqërues të veprimit që kryhet, dhe nëse është në përputhje me projektin dhe komponentët e tij*, veprime këto që bien në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 10296, date 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26. *Trajtuar më hollësisht në faqen nr.60-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Drejtoria e Financës të kërkojnë nga projekti Risi Albania, dokumentacionin origjinal lidhur me shpenzimet e kryera, të verifikojë nëse shpenzimet janë në përputhje me komponentët e projektit, në rast të kundërt nga MMSR të merren të gjitha masat për ndjekjen në rrugë ligjore dhe arkëtimin e vlerës prej 5,940,133 lekë likuiduar në

kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 10296, date 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26.

*Menjëherë*

2. Nga auditimi i fondit të akorduar nga Kryeministri për projektin “Ëndrra ime” u konstatua se:

a. Për projektin “Pastrimi i liqenit të Tiranës” nga mbetjet biologjike dhe mbeturinat e hedhura në një thellësi deri 1.8”, është Lidhur Kontrata nr.114 datë 26.05.2015 me ■■■, me shume financimi në vlerën 1,500,000 lekë, i cili në periudhën që po auditohet ka përfituar 90% të fondit 1,350,000 lekë. Konstatuam se dokumentacioni justifikues për përfitimin e shumës, është në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr.10296, date 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26 ku nga pagesat rezultojnë tre fatura tatimore të shitjes fotokopje përkatësisht:

-Faturë tatimore shitje nr.20 datë 03.07.2015 lëshuar nga shitësi ■■■blerësi ■■■Tiranë. Blerje e 3000 litra karburant në vlerën 540,999 lekë.

-Faturë tatimore shitje nr.21 datë 23.07.2015 lëshuar nga shitësi ■■■blerësi ■■■Tiranë. Blerje e 3200 litra karburant në vlerën 577,199 lekë.

-Faturë tatimore shitje nr.4430 datë 28.07.2015 lëshuar nga shitësi ■■■blerësi ■■■Tiranë. Transport liqeni Kukësit- Liqeni i Tiranës në vlerën 300,000 lekë. *Trajtuar më hollësisht në faqen nr.61-64 të Raporti Përfundimtar të Auditimit.*

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Shërbimi Kombëtar i Rinisë në MMSR të kërkojnë nga përfituesi i projektit ■■■dokumentacionin origjinal lidhur me shpenzimet e kryera, të verifikojë nëse shpenzimet janë në përputhje me projektin, në rast të kundërt nga SHKR të merren të gjitha masat për ndjekjen në rrugë ligjore dhe arkëtimin e vlerës prej 1,350,000 lekë likujduar në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 10296, date 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26.

*Menjëherë*

b. Për projektin “*Festivali i Luleve*” ku do të ekspozohen dhe promovohen produktet bimore, kopshtaria, artet si edhe politikat komunitare mbi mjedisin në qytetin e Përmetit me fitues, ■■■, është lidhur Kontrata nr.101 datë 24.06.2015 në shumën 1,000,000 lekë, paguar 90% e fondit 900,000 lekë si dhe me Urdhër shpenzimi nr.34 datë 30.07.2015 dhe Urdhër shpenzimi nr.93 datë 18.12.2015 është likujduar 10% e shumës, në vlerën 33,802 lekë. Realizimi i projektit është kryer më datë 25 -26 korrik 2015.

Nga auditimi i dokumentacionit justifikues u konstatua se ka shpenzime të kryera dhe likujduara të cilat nuk i përkasin periudhës që është kryer aktiviteti, por i përkasin një periudhe kohere mbas kryerjes së tij, konkretisht: me fature tatimore shitje nr. 09 datë 29.07.2015 është blerë naftë 569,85 litra në vlerën 102.000 lekë; faturë tatimore e thjeshtë nr.19 datë 26.07.2015 transport bicikletash nga Tirana –Përmet në vlerën 30,000 lekë, faturë tatimore e thjashtë nr.18 datë 30.07.2015 blerje lule në vazo në vlerën 17,000 lekë, faturë tatimore e thjeshtë nr.218 datë 28.07.2015 blerje lule në vazo në vlerën 24,000 lekë, faturë tatimore e nr.849 datë 25.07.2015 blerje lule në vazo në vlerën 44,000 lekë në Marikaj , faturë tatimore nr.232 datë 27.07.2015 akomodim në hotel ■■■në vlerën 23,000 lekë, faturë tatimore e thjeshtë nr.7 datë 25.07.2015 koktej për 70 persona në vlerën 23,100 lekë ku fatura i perket restorant ■■■ndërkohe që kuponi tatimor është fotokopje, nëpërmjet bankës me derdhje cash në favor të ■■■, pagesë për Orkestrën në shumën 50,000 lekë në datë 28.07.2015 bazuar në kontratën e shërbimit lidhur më datë 26.07.2015, ndërkohë që referuar raportit narativ të realizimit të projektit ky Koncert festiv është realizuar sipas tye në fund të ditës së parë të aktivitetit datë 25.07.2015. Paguar më datë 05.08.2015 sipas transfertës bankare në shumën 50,000 lekë ■■■ sipas kontratës datë 20.07.2015 në shumën 60,000 lekë, ndërkohë që ■■■ka firmosur dokumenta financiare më herët si Mandat arkëtimi nr.45 datë 16.07.2015. ndërkohë që me Financieren e projektit ■■■ kontrata është lidhur ditën që kryhet aktiviteti 25.07.2015 në shumën 30,000 lekë dhe paguar me transfertë në shumën 25,500 lekë. *Trajtuar më hollësisht në faqen nr.58-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Shërbimi Kombëtar i Rinisë në MMSR të kërkojnë nga përfituesi i projektit, dokumentacionin origjinal lidhur me shpenzimet e kryera, të verifikojë nëse shpenzimet janë në përputhje me projektin, në rast të kundërt nga SHKR të merren të gjitha masat për ndjekjen në rrugë ligjore dhe arkëtimin e vlerës prej 1,000,000 lekë likuiduar në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 10296, date 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26.

#### **Menjëherë**

c. Për projektin “Vënia në skenë në Amfiteatrin e Durrësit të veprës me famë botërore, Ëndrra e një Nate Vere” me fitues është lidhur Kontrata nr.120 prot datë 03.07.2015 me fond të lëvruar 1,975,000 lekë, nëpërmjet tre kësteve, me Urdhër shpenzimi nr.49 datë 16.07.2015 është likuiduar 50% e fondit në shumën 975,000 lekë, me Urdhër shpenzimi nr.68 datë 20.10.2015 është likuiduar 40% e fondit në shumën 636,525 lekë si dhe me Urdhër shpenzimi nr.78 datë 20.11.2015 është likuiduar 10% e fondit në shumën 70,725 lekë. Projekti është realizuar më datë 18 Gusht 2015.

-Konstatuam se asnjëra nga pagesat nuk është likuiduar në të njëjtin numër llogarie të deklaruar prej OE në kontratën e lidhur, një likuidim është kryer në Bank dhe dy të tjerë në Bank (banka e deklaruar) po jo në numrin e llogarisë së deklaruar dhe IBAN e deklaruar në kontratë.

-Konstatohet se shpenzimi i kryer nuk i përket periudhës që është kryer aktiviteti, me fature tatimore shitje nr.16 datë 31.08.2015 është blerë pëlhurë sintetike, metrazhe fjongo, llastik, pëlhurë sintetike në vlerën 99,997 lekë; gjithashtu ka një sërë kontratash të lidhura me aktor, punëtor skene, koreograf etj, këto kontrata janë lidhur mes personave pa ndonjë bazë ligjore, mbi të cilën ato lidhen, sipas parashikimit të Kodit Civil në Republikën e Shqipërisë, kërkon lidhjen e tyre para noterit që të bëhen të vlefshme para ligjit. Gjithashtu vendosja e pagesave nuk ka një referencë mbi çfarë baze është vendosur në atë shumë. *Trajtuar më hollësisht në faqen nr.59-60 të Raporti Përfundimtar të Auditimit.*

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Shërbimi Kombëtar i Rinisë në MMSR të kërkojnë nga përfituesi i projektit Uni Rinor (Durrës) dokumentacionin origjinal lidhur me shpenzimet e kryera, të verifikojë nëse shpenzimet janë në përputhje me projektin, në rast të kundërt nga SHKR të merren të gjitha masat për ndjekjen në rrugë ligjore dhe arkëtimin e vlerës prej 1,975,000 lekë lekë likuiduar në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr.10296, date 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

3. Nga auditimi, i objektit “*Studim projektim për objektin rikonstruksion i dhomës së serverëve dhe rrjetit kompjuterik dhe telefonik*” me fond limit 780,000 (shtatëqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, me burim financimi nga Buxheti i Shtetit për vitin 2014. Nga auditimi i dosjes fizike dhe në sistemin app.gov.al, është vërejtur se, KVO-ja, ka shpallur fitues operatorin ekonomik në kundërshtim me bazën ligjore të prokurimit publik ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Ligji për prokurimet publike” neni 46 pika 1/a, të dokumenteve të tenderit (kapaciteti teknik, pika 2 Licenca profesionale dhe me VKM nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, Kreu III, (Kategorizimi dhe klasifikimi i licencës, elementët e saj, kushtet, kriteret dhe kufizimet) pika 1/b”, pasi ky operator ekonomik nuk zotëron Licensën projektuese e operatorit ekonomik ose bashkim operatorësh ekonomik së bashku, por janë paraqitur vetëm licenca personale profesionale e administratorit (Licencë fotokopje e palexueshme në lidhje afatin e përdorimit). KVO-ja duhet ta konsideronte mangësi paraqitjen e këtyre dokumentacioneve, duke e s’kualifikuar këtë operator ekonomik me vlerë të ofertës tekniko-ekonomik prej 610,000 lekë pa TVSH dhe duhet të kualifikonte operatorin ekonomik (nga auditimi rezulton se i ka në përputhje me bazën ligjore të prokurimit dhe DT të gjithë dokumentacionin e dorëzuar pranë AK dhe në faqen elektronike të app.gov.al) me vlerë të ofertës tekniko-ekonomike prej 532,350 lekë pa TVSH, duke ulur koston e realizimit të studimit të projektit, me diferencë prej 77, 650 lekë pa TVSH ose vlera prej 93,180 lekë me TVSh, e cila përbën dëm ekonomik. *Trajtuar më hollësisht në faqen nr.86-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

KVO të përbërë nga kryetar, dhe vlerën 77,650 lekë pa TVSH ose 93,180 lekë me TVSH, ose nga 25,883 lekë/secili pa TVSH ose 31,060 lekë me TVSH, e cila përfaqëson diferencën midis ofertës të OE të kualifikuar në vend të dytë padrejtësisht dhe të shpallur fitues, në kundërshtim me KVK e miratuar me DST, si dhe përcaktimet e parashikuara në nenin 1 "Objekti dhe qëllimi", të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar. Gjithashtu, MMSR, të marrë masa që në mbështetje në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurës administrative i Republikës së Shqipërisë", Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e Sektorit Publik", kapitulli IV, pika 93, nga titullari i MMSR të nxirren aktet administrative, për të kërkuar shpërblimin e dëmit të shkaktuar buxhetit të shtetit në vlerën totale 77,650 lekë pa TVSH, duke ndjekur të gjithë hapat administrative dhe ligjore.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

4. Për lidhjen e zbatimit të kontratës me objekt monitorimin e mediave të shkruara e audio për vitin 2014, janë konstatuar shkelje të kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit, të cilat janë shoqëruara me dëm ekonomik në vlerën 30,833 lekë pa TVSH, përfituar padrejtësisht nga operatori ekonomik. Mbështetur në ligjin nr.44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurës administrative i Republikës së Shqipërisë", Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e Sektorit Publik", kapitulli IV, pika 93, nga titullari i MMSR të nxirren aktet administrative, për të kërkuar nga OE, shpërblimin e dëmit të shkaktuar buxhetit të shtetit në vlerën totale 37,000 lekë, duke ndjekur të gjithë hapat administrative dhe ligjore. *Trajtuar më hollësisht në faqen nr.47-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

*Për sa më sipër rekomandojmë:*

Mbështetur në ligjin nr.44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurës administrative i Republikës së Shqipërisë", Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e Sektorit Publik", kapitulli IV, pika 93, nga titullari i MMSR të nxirren aktet administrative, për të kërkuar shpërblimin e dëmit të shkaktuar buxhetit të shtetit në vlerën totale 37,000 lekë, duke ndjekur të gjithë hapat administrative dhe ligjore.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## **B.II. MBI ZBATIMIN ME EFICENSË, EFIKASITET DHE EKONOMICITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

Përdorim pa eficientë, efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publik me vlerë prej 17,353,000 lekë pa TVSH, për shkak se është paguar pa dokumenta vërtetues si dhe nga anëtarët e komisionit të mbikëqyrjes së kontratës nuk është përmbushur detyra, për objektin e tenderimit "Organizimi i koncertit të madh përmbyllës dhe fushatës publicitare me rastin e 70-vjetorit të Çlirimit të Vendit", realizuar në vitin 2014. Gjatë auditimit, është konstatuar se, monitorimi i kontratës dhe dokumentimi i shpenzimeve, nuk është bërë me transparencë dhe në përputhje me kërkesat e menaxhimit financiar. Komisioni i mbikëqyrjes së kontratës ka dokumentuar aktivitetin bazuar vetëm në dokumentacionin e firmës kontraktuese, bashkimit të operatorëve ekonomik, pra nuk e ka dokumentuar vetë, duke mbledhur dhe monitoruar fakte dhe dokumenta vërtetues, për realizimin e aktiviteteve për ti krahasuar me kushtet e paracaktuara në dokumentet e tenderit për koncertin. Në relacionin përfundimtar nuk janë evidentuar të gjitha aktivitetet sipas zërave të preventivit fitues, krahasuar me situacionin e dorëzuar nga. Në CD-të bashkëlidhur dokumentacionit të audituar, jepen reklamimi infograf, foto afishimi citylight në qytetin e Tiranës, reklama në audio për radio dhe për çudi në këto CD nuk ka asnjë fragment nga eventit i realizuar. Gjithashtu, nuk është realizuar evidentimi i çdo zëri nga komisioni i monitorimit, duke mos realizuar krahasimet në sasi dhe vlerë midis zërave të shërbimeve të kryer me ato të planifikuara, në dokumentat e tenderit dhe në kontratën e shërbimit, nr.5650/7 datë 14.11.2014. Të gjitha këto veprime janë në kundërshtim me bazën ligjore të prokurimit, konkretisht me Ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, neni 2, 46 dhe VKM nr.1 datë 10.01.2007 "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar, Kreu VIII, Ekzekutimi i kontratës pika 1 (nënkontraktimi, nënpika a, b, c, ç dhe d), pika 2 (mbikëqyrja e kontratës), ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe

Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35/ b dhe pika 36. Për sa më sipër evidentojmë se këto veprime janë kryer nga personat e mëposhtëm:

■ ish-Sekretare e Përgjithshme në MMRS (në cilësinë e nëpunësit autorizues), aktualisht Drejtore e Përgjithshme në ■ ka lejuar të realizohej pagesa pa dokumente vërtetues, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4/9, neni 9 dhe Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35/ b dhe pika 36

■ ish- Drejtore e Financës në MMRS ( në cilësinë e nëpunësit zbatues), aktualisht Drejtore e Finance në ■ ka lejuar të realizohej pagesa pa dokumente vërtetues, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4/9, neni 12 dhe Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35/ b dhe pika 36.

■ kryetar, ■ anëtare, ■ anëtar, ■ anëtare dhe ■ anëtar, në cilësinë e anëtarëve të komisionit të mbikqyerjes së realizimit të kontratës, ngritur me Urdhër nr.225, 20.11.2014 të Ministrisë të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë.

*Trajtuar më hollësisht në faqen nr.77-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

### ***Për sa më sipër rekomandojmë:***

Autoriteti kontraktor, i MMSR-së, për çdo eveniment kulturor në formë koncertesh, të marrë masa për monitorimin e plotë dhe të dokumentuar të kontratave të shërbimit, duke siguruar dokumentimin e plotë vërtetues, në mbështetje të plotë të bazës ligjore. Të përcaktohen procedura të standardizuara jo vetëm të monitorimit por edhe të raportimit financiar të projekteve kulturore dhe të ketë përgjegjësi të përcaktuar funksionale brenda Institucionit për këtë proces.

*Menjherë dhe në vijimësi*

## **C. MASA DISIPLINORE**

### **Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.**

**I.** Mbështetur në nenet, 57, 58, pika (ç) dhe neni 59 pika (b) të ligjit nr. 152/2013 "Statusi i nëpunësit civil", datë 13.05.2013 i ndryshuar dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil" Kreu II, pika 12, i rekomandojmë Departamentit të Administratës Publike, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, për personin e mëposhtëm:

**1.** ■ ish-Sekretare e Përgjithshme në MMRS (në cilësinë e nëpunësit autorizues), aktualisht Drejtore e Përgjithshme në Bashkinë Tiranë ka lejuar të realizohej pagesa pa dokumente vërtetues, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4/9, neni 9 dhe Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35/ b dhe pika 36

Për shkeljet e mëposhtme (**I.1;I.2; I.3;I.4**):

**2.** ■ ish- Drejtore e Financës në MMRS ( në cilësinë e nëpunësit zbatues), aktualisht Drejtore e Finance në Bashkinë Tiranë ka lejuar të realizohej pagesa pa dokumente vërtetues, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 4/9, neni 12 dhe Udhëzimi nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35/ b dhe pika 36

Për shkeljet e mëposhtme (**I.1;I.2;I.3**):

**I.1** Nga auditimi mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e kryerjes së pagesave për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, u konstatua se nga institucioni i Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë (në vazhdim MMSR) është likuiduar shuma prej 20,455,000 lekë, për subjektin ■ për shërbimet e telefonisë fikse ndaj shtresës me aftësi të kufizuara (paraplegjik e tetraplegjik dhe të verbër) periudhën qershor 2001- qershor 2008, si detyrim i pretenduar dhe që i referohet kërkesave të VKM nr.83, datë 26.02.2001 “Për tarifatat telefonike dhe për pagesat e energjisë elektrike nga personat me aftësi të kufizuara” i ndryshuar. Këto fonde janë përballuar nga Fondi i Kontigjencës, sipas

vendimit të Komitetit të Detyrimeve të Prapambetura (KPD) në zbatim të strategjisë për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

a) Konstatuam se pagesa është bërë me urdhër shpenzimi nr.20 datë 28.01.2015, në referencë të Urdhrit nr.242 datë 17.12.2014 dhe Akt rakordimit nr.6483/1 datë 31.12.2014 dhe shkresës së Ministrisë së Financave nr.2/3 datë 20.01.2015.

Shkresa e Ministrisë së Financave nr.2/3 datë 20.01.2015 me subjekt “Akordimi i fondeve në zbatim të Vendimit nr.15 datë 09.01.2014 të Komitetit të Shlyerjes së Detyrimeve të Prapambetura”, i referohet “Vendimit të Komitetit të Detyrimeve të Prapambetura nr.15 datë 09.01.2014, si dhe shkresës së ardhur nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr.229/1 datë 14.01.2015, miratojmë detajimin e fondit sipas tabelave bashkëngjitur”. Shkresa mban firmën e Ministrit të Financës.

Lidhur me këtë praktikë kemi konstatuar që në referencë të shkresës së nr.10598/3, date 25.11.2014 “Dërgim informacioni”, ka dalë Urdhri nr.242 datë 17.12.2014 i Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për ngritjen e grupit të punës për rakordimin e detyrimeve ndaj mbi tarifave të shërbimit telefonik fiks për personat me aftësi të kufizuara. Grupi i punës i koordinuar nga Drejtori i Financës ka në përbërje 15 anëtarë me përgjegjësi të njëjtë. Përgjegjësia e grupit të punës ishte rakordimi i detyrimeve të paraqitura nga shoqëria Altelekom, për detyrimet sipas viteve Qershor 2001- Qershor 2008 dhe Maj 2012 - Korrik 2012.

Lidhur me Akt Rakordimin nr.6483/1 datë 31.12.2014 kemi konstatuar:

1. Dokumenti i Akt Rakordimit është firmosur vetëm nga pala e MMSR dhe nuk ka nënshkrime të palës së Dokumenti nuk është firmosur nga të gjithë pjesëtarët e grupit.

2. Në dokumentet e paraqitura, grupit të auditimit të KLSH-së, mungojnë dokumentet e detyrimeve të pretenduara, të tilla janë, lista e personave përfitues, statusi i tyre, faturat me numrin e impulseve dhe vlera, pjesa e paguar nga personi mbi shumën e rimbursueshme në se ka etj.

Akt Rakordimi cilëson pretendimin për shumën 89,154,753 lekë ndërkohë që grupi ka pranuar vetëm vlerën 21,015,098 lekë. Ndërkohë që për pjesën tjetër është cilësuar fakti se do të vazhdojë verifikimi deri në rakordimin e plotë të detyrimeve.

MMSR me shkresën nr.6776 prot, datë 31.12.2014, kërkesë për akordim të fondit të detyrimeve të prapambetura, drejtuar Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Financave, lidhur me pretendimet e shprehet: “Në lidhje me detyrimet, ndërmjet ish MPCSSHB dhe “”, është rakorduar për periudhën Korrik 2008- Maj 2012. Në fund të rakordimit, nga pretendimi total i prej 98,518,147 lekë, është pranuar e paguar nga ish MPCSSHB, detyrimi prej 51,206,371 lekë, shumë e akorduar me VKM nr.876, date 12.12.2012. Për diferencën 47,311,776 lekë, nuk është rënë dakord midis dy institucioneve”. Mbas verifikimeve të grupit të punës, në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga për periudhën 2001-2007 shuma e rakorduar është 20,455,000 lekë, detyrimi i pretenduar nga është 77,852,315 lekë. Në kërkesë theksohet se, shuma e rakorduar për periudhën 2001-2007, përfaqëson rastet e verifikuara plotësisht sipas dokumentacionit vërtetues të paraqitur në

-Nisur nga kjo shkresë drejtuar Ministrisë së Financave konstatuam se, detyrimi i referohet periudhës së viteve nga 2001 deri në 2007, ndërkohë që pagesa e kryer citon detyrimin për periudhën 2001-2008, për të cilën MMSR ka kërkuar nga Ministria e Financave shumën 20,455,000 lekë.

-Nuk është zbatuar pika 3/b e urdhrit të Ministrit nr.242, date 17.12.2014, lidhur me afatet e përcaktuara për llogaritjen e detyrimeve. Urdhri kërkon saktësimin e detyrimeve për periudhën Qershor 2001- Qershor 2008 dhe Maj 2012- Korrik 2012.

-Shuma e njohur nga ana e MMSR, e detyrimit ndaj është kryer jo sipas të dhënave të financiare ligjore të MMSR-së dhe gjithashtu në institucion nuk u gjenden dokumente si pasqyra financiare ndër vite të certifikuar nga eksperte ligjore të Altelekom për të saktësuar dhe provuar këtë detyrim ndër vite, (mungojnë edhe llogaritë e detyrimeve e marra përsipër në momentin e privatizimit).

Nga auditimi i likuidimeve përmes thesarit konstatuam se gjatë vitit 2014, janë bërë pagesa të lidhura me detyrime të prapambetura për shpenzime telefoni ndaj operatorit vlera 502,300 lekë e konstatuar nuk është materiale por përshkrimi i referohet detyrimeve në vite. Kështu me shkresën nr.2723 prot, datë 30.03.2015, nga është pretenduar shuma 141,048 lekë (për tel. nr.35542233429, sipas dokumenteve nga 31.07.2012 deri më 31.12.2013), me shkresën nr.496 prot, datë 21.01.2015, është pretenduar shuma 26,395 lekë (kontrata nr.1301041043, fatura nr.11907532, datë 31.07.2009, detyrimi 26,395 lekë si dhe kontrata nr.1301047999, 13 fatura nga datat 30.04.2010 deri më

30.04.2012). Me shkresën nr.733 prot, datë 28.01.2015, është pretenduar shuma 16,603 lekë (kontrata nr.1301048713, nr.35542261416, dy fatura datë 30.04.2010 dhe 30.04.2011), si dhe shuma 14,721 lekë (kontrata nr.1301048713, nr.35542261416, dy fatura datë 30.04.2010 dhe 30.04.2011).

Nga auditimi u konstatua se në pasqyrat financiare të institucioneve (ish MPCÇS apo të Shërbimit Social Shtetëror) nuk ka të dhëna për detyrimet e mbartur në vite ndaj [REDAKTUAR] sha për pagesat e shpenzimeve telefonike për personat me aftësi të kufizuar dhe gjithashtu nuk ka të dhëna në formën e një date-baze për numërim sipas emrave dhe rretheve të personave me aftësi të kufizuar ndër vite. Nuk na u vu në dispozicion asnjë marrëveshje, ndërmjet [REDAKTUAR] dhe MMSR për njohjen e detyrimit ndër vite, theksojmë se [REDAKTUAR] sh.a është privatizuar në bazë Ligjit nr.9785, datë 19.07.2007 “Për ratifikim e kontratës për blerjen e aksioneve të shoqërisë anonime [REDAKTUAR]” sha.

Detyrimet e prapambetura janë shlyer në referencë të VKM nr.50, datë 05.02.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5 datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, ku cilësohet *“konsiderohen detyrime të prapambetura, detyrimet financiare të përcaktuara nga një ligj/kontratë/marrëveshje/vendim gjykate i formës së prerë që mbeten të papaguara 30 ditë pas datës së specifikuar në kontratë apo me ligj.* Ndërsa në referencë të pikës 2 të këtij theksohet se...*procedurat e detajuara në këtë udhëzim do të ndiqen vetëm për shlyerjen e detyrimeve financiare të prapambetura që figurojnë si të tilla në pasqyrat financiare të vitit 2013 të njërive të të gjitha niveleve të qeverisjes qendrore, vendore (për financimet nga fondi i zhvillimit rajonal) dhe fondet speciale, të korrigjuara me pagesat e kryera gjatë muajit Janar 2014.* Detyrimi i paguar [REDAKTUAR] nuk figuron në pasqyrat financiare si në MMSR dhe në Shërbimin Social Shtetëror deri më 31.12.2013 e në vazhdim. Udhëzimi i Ministrit të Financave nr.5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, i ndryshuar, në pikën 21 përcakton qartë se *“Nëpunësit autorizues të njërive të qeverisjes qendrore e vendore sigurohen që të gjitha urdhrat e pagesës të paraqitura në degën e thesarit respektiv, të jenë të shoqëruara me dokumentacionin e plotë justifikues të shpenzimit të kryer”.*

Gjithashtu konstatojmë që sipas VKM nr.404, datë 20.06.2012 “Për përcaktimin e masës se kritereve e të procedurave të përfitimit të kompensimit financiar, nga personat me statusin e të verbrit dhe invalidit, paraplegjik dhe tetraplegjik për faturën e energjisë dhe faturën e telefonisë fikse”, sipas pikës 4 thuhet se individët përfitues së statusit sipas ligjit nr.8626, datë 22.06.2000 “Statusi i invalidit, praplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar u jepet kompensim për faturën e telefonisë fikse në masën 1,000 lekë në muaj. Në mënyrë që ta përfitojnë këtë individët duhet të paraqesin në njësitë e qeverisjes vendore dokumentacionin përkatës të përcaktuar në pikën 8 të kësaj VKM. Efektet financiare për vitin 2012 të përballohen nga fondet e miratuara për MPCSSH. Sipas kësaj VKM, pika 12 e VKM nr.83, datë 26.02.2001 shfuqizohet.

VKM nr.850, date 17.12.2004 “Për disa ndryshime në VKM nr.83, date 26.02.2001 “Për tarifatat telefonike dhe për pagesat e energjisë elektrike nga personat me aftësi të kufizuara” i ndryshuar. *Trajtuar më hollësisht në faqen nr.48-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**I.2 Për pagesa të miratuara dhe kryera për rimbursim të TVSH për projektin Risi Albania**, për vitin 2015 janë tetë pagesa në shumën 5,940,133 lekë, të cilat janë paguar dhe miratuar nga thesari, pagesat janë rimbursim i tvsh , kryesisht për shpenzime: Energji elektrike për zyrat e projektit, shpenzime telefonie të zyrës së projektit, materiale zyre, pagese sigurimi shëndeti për punonjësit e zyrë së projektit, blerje kompjuterësh, materiale konsumi zyre,,ujë për zyrën e projektit, darka pune , dreka , coffee break, fotokopje, ëorkshope, pagesë eksperti 16 080 Euro, aktivitet fokus grup, etj, shërbim sipas kontratës në vlerë 1,536,000 lekë , shërbime Rafting +akomodim+darke+ hiking ne Berat, për 11 persona në vlerën 900 Euro, shërbim kokteji për 50 persona, studim balanca gjinore mbi afrimin e informacionit të tregut të punës nëpërmjet medias në Shqipëri (32 ditëx200) euro=6400 euro, shërbim auditimi 3600 euro, trajnim i paketës fiskale 156 euro.etj pagesa e tv [REDAKTUAR] 2,256, 000 lekë ose shërbime sipas kontratës mars 2015 po me [REDAKTUAR] në shumën 1,776,000 lekë , me Tv [REDAKTUAR] për 4 emisione “ drejt punës” në vlerë 198 000 leke, *pa asnjë dokumentacion shoqërues të veprimit që kryhet, dhe nëse është në përputhje me projektin dhe komponentët e tij,* veprime këto që bien në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 10296, date 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe kontrollin”, neni 4, pika 26. *Trajtuar më hollësisht në faqen nr.60-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**I.3** Nga auditimi i procedurës në lidhje mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë, të procedurës Për **“Organizimi i koncertit të madh përmbyllës dhe fushatës publicitare me rastin e 70-vjetorit të Çlirimit të Vendit”**, me fond limit prej 23,230,000 lekë pa TVSH e realizuar në vitin 2014, nëpërmjet dy procedurave *Procedurë e Hapur i anuluar*, dhe *Procedura e II “Negocim pa shpallje të njoftimit të kontratës”*, është evidentuar se, nga autoriteti kontraktor (MMSR), ka përdorim pa efikasitet, efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publik me vlerë prej 17,353,000 lekë pa TVSH, për shkak se është paguar pa dokumenta vërtetues si dhe nga anëtarët e komisionit të mbikëqyrjes së kontratës nuk është përmbushur detyra. Gjatë auditimit, është konstatuar se, monitorimi i kontratës dhe dokumentimi i shpenzimeve, nuk është bërë me transparencë dhe në përputhje me kërkesat e menaxhimit financiar. Komisioni i mbikëqyrjes së kontratës ka dokumentuar aktivitetin bazuar vetëm në dokumentacionin e firmës kontraktuese, bashkimit të operatorëve ekonomikë pra nuk e ka dokumentuar vetë, duke mbledhur dhe monitoruar fakte dhe dokumenta vërtetues, për realizimin e aktiviteteve për të krahasuar me kushtet e paracaktuara në dokumentet e tenderit për koncertin. Në relacionin përfundimtar nuk janë evidentuar të gjitha aktivitetet sipas zërave të preventivit fitues, krahasuar me situacionin e dorëzuar. Në CD-të bashkëlidhur dokumentacionit të audituar, jepen reklamimi infograf, foto afishimi citylight në qytetin e Tiranës, reklama në audio për radio dhe për çudi në këto CD nuk ka asnjë fragment nga eventit i realizuar. Gjithashtu, nuk është realizuar evidentimi i çdo zëri nga komisioni i monitorimit, duke mos realizuar krahasimet në sasi dhe vlerë midis zërave të shërbimeve të kryer me ato të planifikuara, në dokumentat e tenderit dhe në kontratën e shërbimit, nr.5650/7 datë 14.11.2014. Të gjitha këto veprime janë në kundërshtim me bazën ligjore të prokurimit, konkretisht me Ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 2, 46 dhe VKM nr.1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu VIII, Ekzekutimi i kontratës pika 1 (nënkontraktimi, nënpika a, b, c, ç dhe d), pika 2 (mbikëqyrja e kontratës), ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35/ b dhe pika 36. *Trajtuar më hollësisht në faqen nr.77-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**I.4** Nga auditimi i të gjitha objekteve tenderuese për rikonstruksionin e objekteve, blerjen e mallrave dhe kryerjen e shërbimeve për vitin 2014 deri në muajin gusht të vitit 2015 (në gusht personi i mësipërm është larguar, duke marrë një pozicion tjetër shtetëror drejtues), është konstatuar se në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, nuk është ngritur Njësia e Prokurimit Publik, si pasojë e mungesës së saj janë evidentuar mangësi, duke prezantuar fiktiviteti në studimin e tregut për prokurimet për blerje mallra, duke marrë oferta nga ato subjekte që nuk kanë si aktivitet kryesor mallin, shërbimin që do prokurohet. Dokumentet e tenderit, nuk janë paraqitur në mënyrë të hollësishme duke e argumentuar për çdo kriter të veçantë. Anëtarët, në grupet e punës për llogaritjen e vlerës së kontratës kanë rezultuar jo specialistë të fushës së prokurimit. *Trajtuar më hollësisht në faqen nr.65-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**Menjëherë**

**II.** Mbështetur në nenet, 57, 58, pika (ç) dhe neni 59 pika (b) të ligjit nr. 152/2013 "Statusi i nëpunësit civil", datë 13.05.2013 i ndryshuar dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil" Kreu II, pika 12, i rekomandojmë Departamentit të Administratës Publike, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masës disiplinore “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj” e parashikuar në nenin 58 shkronja (b) deri “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet” në nenin 58 shkronja (c), për personin e mëposhtëm:

**1.** ■ ish- Drejtor i Përgjithshëm në MMSR, në cilësinë e Kryetarit të komisionit të vlerësimit Për shkeljet e mëposhtme:

**II.1** Nga auditimi i procedurës në lidhje mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë, të procedurës **“Fushatën e komunikimit për Reformën në fushën e Sigurimeve Shoqërore”** e realizuar sipas VKM-së nr.1195 datë 05.08.2008 **“Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e**

**programeve a të reklamave për transmetim nga operatorët radioteleviziv ose botim në median e shkruar, dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore**” nisur në dhjetor të vitit 2014 dhe realizuar në mars të vitit 2015 është vërejtur se, nga ana e komisionit të vlerësimit, vlera e prodhimit të spotit nuk është e detajuar me elementët të citët e ndërtojnë spotin, por është dhënë vetëm një vlerë totale si dhe publikimi i spotit vetëm në rrjetet sociale nuk është argumentuar, se në cilat eksperiencia është bazuar për caktimin e vlerës në facebook. Grupi i KLSH-së, konstaton se, komisioni i vlerësimit, shoqërinë ■■■ e ka shpallur fituese, në kundërshtim me VKM nr.1195 datë 05.08.2008, pika 7, pasi në bazë të auditimit të ekstraktin e regjistrin tregtar për të dhënat e subjektit me shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, nuk rezulton që është organ i medias apo agjenci e specializuar.

Autoriteti publik MMSR, ka miratuar në komisionin e vlerësimit 5 anëtarë, tre prej tyre nuk janë specialistë të fushës, kjo në kundërshtim me pikën 8 të VKM së mësipërme (nga auditimi rezulton se asnjë anëtar i komisionit nuk është specialist i fushës, në fushën e reklamave). Nga auditimi konstatohet se, *mbikëqyrja e realizimit të kontratës*, është realizuar nga komisioni i monitorimit. Nga dokumentacioni i dorëzuar nga shoqëria ■■■ shpk, për pagesën e këtij shërbimi pranë MMSR (e cila deri në momentin që është hartuar ky material nuk është paguar), rezulton, faturimi total i ndarë (pjesa krijimit të spotit dhe publikimi në facebook dhe Twiteer) ku vlera prej 3,210,350 lekë pa TVSH (publikimi në facebook dhe tëiteer), nuk dokumentohet si blerje e hapësirës publicitare tek administratori në faqen facebook, pasi nuk është e dokumentuar me asnjë shkresë apo kërkesë drejtuar administratorit në facebook, për blerjen e hapësirës publicitare, ndërsa në lidhje me tëiter nuk reklamohet asnjë dokument vërtetues. Pra, hapja e një llogarie (të cilën mund ta bëjë cilido individ dhe të hedh video në të), *nuk justifikon shumën e kërkuar prej 3,210,350 lekë pa TVSH*. Nga ana e komisionit të vlerësimit nuk ka dokument të hartuar ku të shpjegohet dhe argumentohet, pse janë zgjedhur pikërisht këto ëeb dhe cila është mënyra sesi do të realizohet pikërisht ky, publikim. Pra në asnjë moment nuk del parashikimi për blerjen e një hapësire publicitare të rezervuar në këto ëeb-facebook dhe tëiter. Gjithashtu, nga auditimi, rezulton , se nuk është parashikuar si në vitin 2014 dhe në vitin 2015, në buxhetin e MMSR ky shpenzim , kjo në kundërshtim me ligjin e Menaxhimit financiar, si dhe nga administrata aktuale nuk është realizuar pagesa e kontratës së mësipërme. *Trajtuar më hollësisht në faqen nr.83-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**Menjëherë**

**III.** Mbështetur në nenin 58 “llojet e masave disiplinore” shkronja “b”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” i rekomandojmë Ministrin të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, që ti kërkojë Komisionit disiplinor, pranë Institucionit Tuaj , *të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore*, nga masa disiplinore **“Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj”** e parashikuar në nenin 58 shkronja (b) deri **“pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”** në nenin 58 shkronja (c), për personat e mëposhtëm:

1. ■■■ Drejtor në MMSR, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit
2. ■■■ specialiste në MMSR, në cilësinë e anëtares të komisionit të vlerësimit
3. ■■■ specialiste në MMSR , në cilësinë e anëtares të komisionit të vlerësimit

Për shkeljet e mëposhtme:

**III.1** Nga auditimi i procedurës në lidhje mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë, të procedurës **“Fushatën e komunikimit për Reformën në fushën e Sigurimeve Shoqërore”** e realizuar sipas **VKM-së nr.1195 datë 05.08.2008 “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve a të reklamave për transmetim nga operatorët radioteleviziv ose botim në median e shkruar, dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore”** nisur në dhjetor të vitit 2014 dhe realizuar në mars të vitit 2015 është vërejtur se, nga ana e komisionit të vlerësimit, vlera e prodhimit të spotit nuk është e detajuar me elementët të citët e ndërtojnë spotin, por është dhënë vetëm një vlerë totale si dhe publikimi i spotit vetëm në rrjetet sociale nuk është argumentuar, se në cilat eksperiencia është bazuar për caktimin e vlerës në facebook. Grupi i KLSH-

së, konstaton se, *komisioni i vlerësimit*, shoqërinë ■■■ e ka shpallur fituese, në kundërshtim me VKM nr.1195 datë 05.08.2008, pika 7, pasi në bazë të auditimit të ekstraktin e regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit me shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, nuk rezulton që është organ i medias apo agjenci e specializuar.

Autoriteti publik MMS&R, ka miratuar në komisionin e vlerësimit 5 anëtarë, tre prej tyre nuk janë specialistë të fushës, kjo në kundërshtim me pikën 8 të VKM së mësipërme (nga auditimi rezulton se asnjë anëtar i komisionit nuk është specialist i fushës). Nga auditimi konstatohet se, *mbikëqyrja e realizimit të kontratës*, është realizuar nga komisioni i monitorimit. Nga dokumentacioni i dorëzuar nga shoqëria ■■■ shpk, për pagesën e këtij shërbimi pranë MMS&R( e cila deri në momentin që është hartuar ky material nuk është paguar), rezulton, faturimi total i ndarë (pjesa krijimit të spotit dhe publikimi në facebook dhe Twiteer) ku vlera prej 3,210,350 lekë pa TVSH (publikimi në facebook dhe tëiteer), nuk dokumentohet si blerje e hapësirës publicitare tek administratori në faqen facebook, pasi nuk është e dokumentuar me asnjë shkresë apo kërkesë drejtuar administratorit në fb, për blerjen e hapësirës publicitare, ndërsa në lidhje me të tjerë nuk reklamohet asnjë dokument vërtetues. Pra, hapja e një llogarie (të cilën mund ta bëjë cilido individ dhe të hedh video në të), ***nuk justifikon shumën e kërkuar prej 3,210,350 lekë pa TVSH.*** Nga ana e komisionit të vlerësimit nuk ka dokument të hartuar ku të shpjegohet dhe argumentohet, pse janë zgjedhur pikërisht këto ëeb dhe cila është mënyra sesi do të realizohet pikërisht ky, publikim. Pra në asnjë moment nuk del parashikimi për blerjen e një hapësire publicitare të rezervuar në këto ëeb facebook dhe të tjerë. Gjithashtu, nga auditimi, rezulton nuk është parashikuar si në vitin 2014 dhe në vitin 2015, në buxhetin e MMSR, kjo në kundërshtim me ligjin e Menaxhimit financiar, si dhe nga administrata aktuale nuk është realizuar pagesa e kontratës së mësipërme. *Trajtuar më hollësisht në faqen nr.83-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

*Menjëherë*

## **D. MASA ADMINISTRATIVE**

**I.** Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike në nenet 2, 19/1, 23, 24, 33, 46, 64/2, etj, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalet nr. 1, 2, 3, 5, vërejtjeve komentet e subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit përfundimtar të auditimit.

Mbështetur në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), 9 punonjësve si më poshtë:**

- |        |                 |
|--------|-----------------|
| 1. ■■■ | në 2 procedura, |
| 2. ■■■ | në 3 procedura, |
| 3. ■■■ | në 3 procedura, |
| 4. ■■■ | në 1 procedurë, |
| 5. ■■■ | në 1 procedurë, |
| 6. ■■■ | në 2 procedurë, |
| 7. ■■■ | në 1 procedurë, |
| 8. ■■■ | në 1 procedurë, |
| 9. ■■■ | në 1 procedurë, |

pasi u konstatuan shkelje në procedurat me objekt:

**1. “Rikonstruktion, kthim në Qendër Rinore, Tiranë”**, Në auditimin për prokurimin me objekt “Rikonstruktion, kthim në Qendër Rinore, Tiranë” AK ka realizuar procedurën e prokurimit “Kërkesë për propozim” viti 2014, me vlerë të prej 5,898,793 lekë pa TVSH, rezultoi se;

-Ky investim është realizuar në ambjentin prej 369 m<sup>2</sup>, e marrë në përdorim në bazë të Kontratës Huapërdorjes (pa qira) të datës 30.04.2014, e nënshkruar nga MMSR me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë, me afat të përdorimit të pacaktuar. Vlera investimi nuk del në vlerën kontabël të godinës, pasi figuron në administrim të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, kjo në kundërshtim me ligjin nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" neni 6 dhe udhëzimin nr.30 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pjesa III (Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre) pika 26, 28 dhe 30.

- Përfaqësuesit e Autoritetit kontraktor me, përfaqësuesit e operatorit ekonomik fitues dhe mbikëqyrësi i punimeve, kanë kërkuar shtesë fondi për preventivin e punimeve, me vlerën prej 5,100,000 lekë (vlerë kjo mbi 80% të vlerës së prokuruar). Ky veprim është ndërmarrë në kundërshtim me ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike" i ndryshuar, neni 24 pika d dhe neni 33, pika 5/b. *Nisur nga këto kushte, Autoriteti kontraktor duhej të anulonte këtë procedurë dhe të zhvillonte procedurë të re.* Gjithashtu, vihet re se pjesa më e madhe e zërave të projektit tenderues nuk figurojnë, por janë zëvendësuar me zëra të rinj, ku të gjitha këto ndryshime, nuk janë të shoqëruara me relacion tekniko- ekonomik nga projektuesi (UNDP), konkretisht kapitulli preventiv punime pjesa C me vlerë prej 3,010,426 lekë pa TVSH, i pa shoqëruar me relacion tekniko- ekonomik nga projektuesi (UNDP) dhe pa miratimin nga projektuesi kjo në kundërshtim ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimet publike" i ndryshuar, ligjin nr. 8402 datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 3 datë 15.02.2001, i ndryshuar pika I "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", ndryshuar me udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 1 datë 16.06.2011. Gjithashtu, kjo "shtesë kontrate" është siguruar prej Kontratë Sponsorizimi nr.3129 prot datë 29.01.2015 midis ■ Bank sh.a dhe Shërbimit Kombëtar për Rininë, ndërkohë që investimi ka mbaruar në datën 13.01.2015. Shuma prej 5,100,000 lekë nuk ka kaluar nëpërmjet thesarit, veprim në kundërshtim ligji nr.7892 datë 21.12.1994 "Për sponsorizimit" neni 4. Gjithashtu, Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT) me vendim nr.2, datë 27.01.2015 ka miratuar Lejen e Ndërtimit me destinacion përdorimin nga Shërbimi Kombëtar për Rininë (si institucion varësie e MMS&R). Leja e ndërtimit është marrë më vonë se janë zhvilluar procedurat e prokurimit dhe likuidimit të situacionit pjesor, (leja e ndërtimit datë 25.01.2015, kontrata është lidhur në datën 10.11.2014) si dhe investimi ka mbaruar në datën në datën 13.01.2015), kjo në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", me Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr. 2 datë 13.05.2005, i ndryshuar pika 3.1. *Trajtuar më hollësisht në faqen nr.69-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

2.Nga auditimi i procedurës në lidhje mbi zbatimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë, të procedurës Për "**Organizimi i koncertit të madh përmbyllës dhe fushatës publicitare me rastin e 70-vjetorit të Çlirimit të Vendit**", me fond limit prej 23,230,000 lekë pa TVSH e realizuar në vitin 2014, nëpërmjet dy procedurave *Procedurë e Hapur i anuluar, dhe Procedura e II "Negocim pa shpallje të njoftimit të kontratës"*, është evidentuar se, nga autoriteti kontraktor (MMSR) , ka përdorim pa efikasitet, efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publik me vlerë prej 17,353,000 lekë pa TVSH, për shkak se është paguar pa dokumenta vërtetues si dhe nga anëtarët e komisionit të mbikëqyrjes së kontratës nuk është përmbushur detyra. Gjatë auditimit, është konstatuar se, monitorimi i kontratës dhe dokumentimi i shpenzimeve, nuk është bërë me transparencë dhe në përputhje me kërkesat e menaxhimit financiar. Komisioni i mbikëqyrjes së kontratës ka dokumentuar aktivitetin bazuar vetëm në dokumentacionin e firmës kontraktuese, bashkimit të operatorëve ekonomik ■ pra nuk e ka dokumentuar vetë, duke mbledhur dhe monitoruar fakte dhe dokumenta vërtetues, për realizimin e aktiviteteve për ti krahasuar me kushtet e paracaktuara në dokumentet e tenderit për koncertin. Në relacionin përfundimtar nuk janë evidentuar të gjitha aktivitetet sipas zërave të preventivit fitues, krahasuar me situacionin e dorëzuar nga ■ Në CD-të bashkëlidhur dokumentacionit të audituar, jepen reklamimi infograf, foto afishimi citylight në qytetin e Tiranës, reklama në audio për radio dhe për çudi në këto CD nuk ka asnjë fragment nga event i realizuar. Gjithashtu, nuk është realizuar evidentimi i çdo zëri nga komisioni i monitorimit, duke mos realizuar krahasimet në sasi dhe vlerë midis zërave të shërbimeve të kryer me ato të planifikuara, në dokumentat e tenderit dhe në kontratën e shërbimit, nr.5650/7 datë 14.11.2014. Të gjitha këto veprime janë në kundërshtim me bazën ligjore të prokurimit, konkretisht me Ligjin nr.9643 datë

20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 2, 46 dhe VKM nr.1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu VIII, Ekzekutimi i kontratës pika 1 (nënkontraktimi, nënpika a, b, c, ç dhe d), pika 2 (mbikëqyrja e kontratës), ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35/ b dhe pika 36. *Trajtuar më hollësisht në faqen nr.77-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**3. “Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike të objektit dhe ambienteve rrethues të MMSR”** realizuar viti 2014, nëpërmjet tre procedurave janë vërejtur mangësi: **Procedurë I e anuluar**, NjHD, nuk ka kërkuar shprehimisht ndërlidhjen e ofertës me elementët e saj (preventivi/analizë/ kosto), por ka kërkuar një ofertë në të cilën përfshihen të gjitha shpenzimet dhe detyrimet fiskale, kjo në kundërshtim me nenin 23 (Specifikimet teknike) pika 1, të LPP-së. Ky fakt, ka sjellë konfuzion në mënyrën e ofertimit nga ana e operatorëve ekonomikë, ku një pjesë e operatorëve pjesëmarrës kanë ofertuar në total, kurse disa të tjerë kanë paraqitur edhe analizë kostoje. Kështu, për rrjedhojë ka pasur disa ankesa nga OE pranë KPP-së, i cili ka vendosur, me vendim nr.137/2014 të datës 11.04.2014, *që autoriteti kontraktor, të anulojë procedurën e prokurimit, duke e rishpallur me korrigjimet në shkeljet e konstatuara. Procedura II* “Kërkesë për propozim”, nga skualifikimet e operatorëve ekonomikë nga KVO-ja, ka pasur ankesa në KPP, i cili me vendimin nr.376/2014 datë 09.07.2014, i ka kërkuar autoritetit publik të MMS&R, të rikuafikojë OE [REDACTED] dhe të skualifikojë të gjithë OE pjesëmarrës të kualifikuar. Ky vendim i KPP-së nuk është zbatuar nga AK i MMS&R, kjo në kundërshtim me ligjin nr.9643 datë 20.12.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 19/1 në pikën 2, gjithashtu në bazë të nenin 64/2 (Vendimet e KPP), pika 2, ku në rast të moszbatimit, duhet të ankimonte vendimin e KPP pranë gjykatës administrative, gjë të cilën nuk e ka bërë. Procedurë e II-të, është anuluar nga MMS&R, në bazë të MEMO datë 10.07.2014, *ku kryetari i KVO [REDACTED] referon se është konstatuar se ka gabim në llogaritjen e fondit limit.* Ky justifikim duket joserioz, në rrethanat mbi të cilën është zhvilluar procedura. Duke u nisur nga elementët e mësipërm, audituesit e KLSH-së, e vlerësojnë, se kemi dy momente për të cilat *AK ka vepruar në kundërshtim nga ana e procedurave duke mos respektuar ligjin e LPP-së, momenti i parë*, AK nuk ndodhet në asnjë nga kushtet e për anulimin e procedurës II, në kundërshtim të ligjit nr.9643, datë 20.12.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, kreu IV (llojet dhe përzgjedhja e procedurës) pika 5/a dhe *momenti i dytë mos respektim të procedurave prokurorese në kundërshtim të plotë me ligjin nr.9643 datë 20.12.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 19/1 në pikën 2 përcaktohet se “Komisioni i Prokurimit Publik, në përfundim të shqyrtimit të ankesave, merr vendime, të cilat janë administrativisht përfundimtare”, në nenin 64/2 (Vendimet e KPP), pika 2. Trajtuar më hollësisht në faqen nr.72-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

**4. “Studim projektim për objektin rikonstrukcion i dhomës së serverëve dhe rrjetit kompjuterik dhe telefonik”** me fond limit 780,000 (shtatëqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, me burim financimi nga Buxheti i Shtetit për vitin 2014. Nga auditimi i dosjes fizike dhe në sistemin app.gov.al, nga ana e audituesve të KLSH-së është vërejtur se, KVO-ja, ka shpallur fitues operatorin ekonomik [REDACTED] në kundërshtim me bazën ligjore të prokurimit publik ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Ligji për prokurimet publike” neni 46 pika 1/a, të dokumenteve të tenderit (kapaciteti teknik, pika 2 Licenca profesionale dhe me VKM nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, Kreu III, (Kategorizimi dhe klasifikimi i licencës, elementët e saj, kushtet, kriteret dhe kufizimet) pika 1/b”, pasi ky operator ekonomik nuk zotëron *Licencën projektuese e operatorit ekonomik ose bashkim operatorësh ekonomik së bashku, por janë paraqitur vetëm licenca personale profesionale e administratorit (Licencë fotokopje e palexueshme në lidhje afatin e përdorimit).* Kështu, KOV-ja duhet ta konsideronte mangësi paraqitjen e këtyre dokumentacioneve, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik [REDACTED] shpk me vlerë të ofertës tekniko-ekonomik prej 610,000 lekë pa TVSH dhe duhet të kualifikonte operatorin ekonomik [REDACTED] (nga auditimi rezulton se i ka në përputhje me bazën ligjore të prokurimit dhe DT të gjithë dokumentacionin e dorëzuar pranë AK dhe në faqen elektronike të app.gov.al) me vlerë të ofertës tekniko-ekonomike prej 532,350 lekë pa TVSH, duke ulur koston e realizimit të studimit të projektit ,

me diferencë prej 77,650 lekë pa TVSH ose vlera prej 93,180 lekë me TVSh, e cila përbën dëm ekonomik. Trajtuar më hollësisht në faqen nr.86-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

**Menjëherë**

## **E. TË TJERA**

Ky auditim është vlerësuar dobët nga Kryetari po ashtu si dhe auditimi i mëparshëm i realizuar pranë Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë për projektin e modernizimit të asistencës sociale me objekt “Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare për periudhën nga fillimi i projektit deri në 28.02.2014”, duke kërkuar që ky subjekt duhet të programohet në planin e auditimeve të vitit 2017, me një shtrirje më të gjatë kohore duke përfshirë dhe aspekte të cilat nuk u mbuluan me cilësi dhe profesionalizëm nga ky grup auditimi.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**